

**PËLLUMB XHUFI****FLUKSE MIGRATORE SHQIPTARE NGA MOREA DREJT  
ITALISË, SHEK. XV-XVII**

Kur flitet për flukset migratore shqiptare të Mesjetës, me to kuptohen para së gjithash ato të shek. XIV drejt Greqisë si dhe flukset e mëvonshme që ndoqën drejtimin e Italisë e të Dalmacisë<sup>1</sup>. Ikjet masive të popullsisë shqiptare drejt Italisë së Jugut e Sicilisë nga brigjet lindore të Adriatikut e të Jonit, fillojnë gjatë përplasjeve të mëdha me turqit osmanë, në shek. XV, dhe vazhdojnë me intensitet të lartë pas pushtimit të atyre viseve, deri në shek. XVII. Qysh në vitin 1461, në letrën për kontin Giovanni Antonio Orsini të Tarantos, Gjergj Kastrioti paralajmëronte popullimin me shqiptarë të trevës së Puljes, atë kohë e

<sup>1</sup> Po japim më poshtë bibliografinë kryesore të shfrytëzuar nga ne: Pietro Pompilio Rodotà, *Dell'origine, progresso e stato presente del rito greco in Italia*, vol. III, Roma: Giovanni Salomoni, 1763; Jacob Philipp Fallmerayer, *Das Albanesische Element in Griechenland*, Abhandlungen der kaiserlichen bayerischen Akademie der Wissenschaften, III. Cl. IX. Bd. II. Abteilung, München: 1860; Denis Zakythinos, *Le despotat grec de Morée*, vëll. II, Athènes: 1953, f. 29-36; Kostas Mpires, *Arbanites, oi Dorieis tou neoterou ellenismou*, Athenai: 1960; Apostolos Vakalopoulos, *Istoria tou neoterou helenismou*, vëll. I, Thessalonike: 1961, f. 25-33; Titos Jochalas, *Über die Einwanderung der Albaner in Griechenland*. Dissertationes Albanicae 12. Band, München: 1971; Peter Topping, "Albanian settlements in the Medieval Greece: some venetian testimonies", në *Charanis Studies*, bot. A. Laiou-Thomadakis, New Jersey: 1980; Pëllumb Xhufi, "Migrimet shqiptare në Greqi në shek. XIV", në *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 1991, f. 3-33; Alain Ducellier, "Les Albanais en Italie centrale à la fin du Moyen Âge: de l'émigration à l'intégration", në *L'Ethnographie, Revue della Société d'Ethnographie de Paris*, 85/2, 1989, f. 76 vj.; Alain Ducellier, *Oi Albanoi sten Ellada (XIII-XV aiona): e metanasteuse mias koinotetas*, Athena: 1994; Alain Ducellier (bot.), *Les chemins de l'exil*, Paris: Armand Colin, 1992; Paolo Petta, *Stradioti, soldati albanesi in Italia (sec. XV-XIX)*, Lecce: Argo ed., 1996; Paolo Petta, *Despoti d'Epiro e principi di Macedonia*, Lecce: Argo ed., 2000; Brunehilde Imhaus, *Le minoranze orientali a Venezia 1300-1510*, Roma: Il Veltrò ed., 1997; Shkëlzen Raça, *Shtegtimet dhe ngulimet e shqiptarëve në Greqi shek. XIII-XVI*, Prishtinë: 2004; Lucia Nadin, *Migrazioni e integrazione: il caso degli Albanesi a Venezia (1479-1552)*, Roma: Bulzoni ed., 2008.

braktisur dhe e shkretuar<sup>2</sup>. Një dëshmi të parë të fillimit të eksodit shqiptar drejt brigjeve të Puljes e jep letra e papës Pali II për dukën e Burgonjës, e vitit 1467. “Të qan zemra”, shkruante Papa, “kur sheh ato anije refugjatësh që ndalen në portet e Italisë dhe familje të tëra të katandisura si mos më keq, të zhveshura, pa plang e katandi, që zbresin në breg e shtrijnë duart drejt qiellit duke mbushur me vuajtjet e tyre botën që i rrethon”<sup>3</sup>. Akoma më e gjallë është dëshmia e Marino Sanudos e vitit 1499. Sipas tij, mendjen e banorëve të Lezhës e kishte pushtuar atë kohë “sëmundja e ikjes” (*malattia di fluxo*), gjë që shtyu krerët e vendit t’i kërkonin qeveritarit venecian të Ulqinit, Piero Nadal, të dërgonte në Lezhë një proveditor e përforcime ushtarake për të ndalur eksodin drejt Puljes, i cili, për më tepër ishte duke shkaktuar viktima të shumta<sup>4</sup>. I njëjti panik mbizotëronte atë kohë edhe në qytetin e Tivarit, edhe pse qyteti do të binte në dorë të osmanëve gati një shekull më vonë, më 1571. Siç lexohet në një burim arkivor, në vitin 1478 “qyteti i Tivarit, që është ipeshkvia e parë e Shqipërisë, u braktis krejt nga banorët dhe mbeti i pabanuar për shkak të frikës së Turkut”<sup>5</sup>. Ky informacion përmban nota të kuptueshme ekzagjerimi, pasi hemorragjia njerëzore vazhdonte në Tivar edhe pak vite para pushtimit të qytetit nga turqit. Më 1566 flitet për familje fisnike që largoheshin përgjithmonë nga qyteti (*zintilhomini che scampano fuor della Terra con la fameglia*)<sup>6</sup>.

<sup>2</sup> “*et etiam bisognando andaremo personalmente con tanta gente che non solamente con lo ayuto de Dio credeamo reaquistare Puglia ma bastiamo de popularla tutta essendo despopulata*”, Jovan Radonić, *Durađ Kastriot Skenderbeg i Arbanija u XV veku*, Beograd: Srpska Kraljevska Akademija, 1942, f. 121.

<sup>3</sup> “*e fa scappar le lagrime l’osservar le navi de’fuggiaschi nell’approdar I porti dell’Italia ed anche le stesse famiglie, ridotte bisognose, e nude, e spogliate delle loro sedi, di tratto in tratto sedersi nelle spiagge, e distender le mani al cielo e d’empire di afflizioni ogni cosa*”, Nicolò Chetta, *Tesoro di Notizie su de’Macedoni*, bot. Matteo Mandalà, Contessa Entellina: Università degli Studi di Palermo, 2002, f. 371.

<sup>4</sup> Marino Sanudo, *Diarii*, a cura di G. Berchet, vol. II, Venezia: 1879, col. 1143. Nga ana e tij, Gjon Muzaka në Kronikën e tij shkruar më 1510, rrëfen plot kolorit largimin e tij dhe të familjes nga Durrësi në bordin e një anijeje tregtare. Shih: Giovanni Musachi, “Historia della casa Musachia”, në Charles Hopf, *Chroniques gréco-romanes inédites ou peu connues*, Berlin: 1873, f. 273-277.

<sup>5</sup> “*la città de Antivari, la quale è il primo vescovato de la Albania, è stato habandonata in tutto dalli habitanti et relicta inhabitata per paura desso Turco*”, Vikentii Makushev, *Monumenta Slavorum Meridionalium*, vëll. I, Varshavë: 1874, f. 180.

<sup>6</sup> *Archivio di Stato di Venezia* (më tej: ASV), *Sen. Mar.*, filza 37 (marzo-agosto 1567): raport i Thomaso Pasqualigo, Podestà i Tivarit, 25 tetor 1566.

Në fakt, fisnikë shqiptarë nga qyteti apo nga fshati, ishin ndër të parët që vendosën të largohen përballë avancimit të invazionit osman. Qysh më 1387, princi Karl Topia, i pamundur t'i bëjë ballë osmanëve, i propozoi Venedikut t'i dorëzonte qytetin e Durrësit, në këmbim të ndonjë prone në ishullin e Kretës apo në atë të Eubesë, që ishin zotërime të Republikës<sup>7</sup>. Të tjerë zotër shqiptarë, si Konstandin Balsha, në veri, apo Rugina Balsha e Vlorës e Gjon Zenebishi i Gjirokastrës, në jug, hynë në negociata me Venedikun për t'i dorëzuar atij zotërimet e veta, kundrejt ndonjë prone e jete të qetë në ndonjë zotërim venecian<sup>8</sup>. Nga ana tjetër, në qershor 1451, marrëveshja mes Gjergj Arianitit dhe Mbretit Alfonsi V i Napolit parashikonte që, në rast nevoje, Arianiti do mund të zhvendosej me familje e pasuri në Mbretërinë e Napolit<sup>9</sup>. Këtë kapitull tragjik të historisë shqiptare të shek. XV e pikturon mjeshtërisht me një frazë të vetme kronisti Gjon Muzaka, kur thotë: “e kështu vepruan të gjithë zotërit e Shqipërisë, dikush prej tyre u largua nga vendi, dikush tjetër u bë mysliman: e kështu mori fund gjithçka” (*e così fecero anco quell'altri Signori d'Albania, chi fuggì e chi se fè Turco: il tutto andò in roina*)<sup>10</sup>.

### Stratitët shqiptarë të Moresë

Në kapërcim të shek. XIV-XV, një valë e pashembullt e emigracionit shqiptar përfshiu krahinat e Peloponezit si Korinthiakun, Akenë, Elidën, Arkadinë, Argolidën, Meseninë, Lakoninë si dhe ishujt e afërt Salaminë, Eginë, Andros, Poros, Hidra e Specie<sup>11</sup>. Njoftimi i parë për dyndjen në Peloponez të rreth 10 mijë shqiptarëve, të organizuar në grupe familjare e

<sup>7</sup> *Acta et Diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia* (më tej: *Acta Albaniae*), ed. L. Thalloczy, C. Jireček, M. Šufflay, vëll. II, Vjenë: 1918, nr. 409, f. 98.

<sup>8</sup> *Po aty*, II, nr. 503; “*Et ulterius in dicta terra et insula nostra Corphoy emere aliquas possessiones*”, *Acta Albaniae Veneta*, pars II, tom 7, nr. 1890; Pëllumb Xhufi, *Nga Paleologët te Muzakajt: Berati dhe Vlora në shek. XII-XV*, Tiranë: 55, 2009, f. 301-338.

<sup>9</sup> “*et la predicta Maestà promete a lo dicto Aranito assignare ad ipso Aranito o ad cui vorra pro sua parte alcuna terra o castello in quisto Reame, in lo quale possa tenere la sua famigla, robe e bestiame franco e libero de herbagii e altre angarie pertinente a la sua Maestà*”, J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg i Arbanija u XV veku ...*, nr. 48, f. 29.

<sup>10</sup> G. Musachi, “*Historia della casa Musachia ...*”, f. 276.

<sup>11</sup> Ioannis Poulos, “*E epoikesis ton Albanon eis Korinthian*”, *Epeteris tou Mesaionikou Archeiou*, 3, Athinai: 1950, f. 51; D. Zakythinos, *Le despotat grec de Morée ...*, vol. II, f. 32 vj.

të prira nga luftëtarë të fortë (ἀγαθοὺς στρατιώτας) i përket viteve të para të shek. XV<sup>12</sup>. Por ardhja e grupeve të emigrantëve shqiptarë nga Shqipëria drejt viseve greke kishte filluar më parë, dhe vazhdoi edhe pas kësaj date. Kur turqit osmanë filluan të shtien në dorë viset e Peloponezit, ata gjetën aty një situatë etnike të ndryshme nga ajo që kishte qenë deri në dekadat e fundit të shek. XIV. Një regjistër osman i vitit 1461, që shënon disa nahije të Peloponezit Qendror dhe Verior, jep një kuadër mbresëlënës të kolonizimit shqiptar të atyre trevave. Prej 198 vendbanimeve të regjistruara, 155 dallohen si vendbanime shqiptare<sup>13</sup>. Viti 1461 i përket edhe një regjistër tjetër osman, ai i krahinës së Korintit. Edhe aty, nga 20 lokalitete të regjistruara, 16 të tilla përcaktohen si shqiptare<sup>14</sup>. Atë kohë, despoti bizantin i Moresë, Manuel Kantakuzeni sundonte, me sa duket, mbi shtetas në shumicë shqiptarë, përderisa quhej si “*despot i shqiptarëve*” (ὁ δεσπότης τῶν Ἀλβανιτῶν)<sup>15</sup>.

E banuar dendësisht nga shqiptarë ishte posaçërisht krahina më jugore e Moresë, ajo e Manit. Ishte krahina, që më së shumti u shkatërrua nga luftërat e kryengritjet antiosmane të popullsisë së atyshme shqiptare. Kuptohet, që Mani ishte edhe krahina që më shumë se çdo krahinë tjetër e Moresë u prek nga eksodi i banorëve të saj në drejtim të ishujve të Egjeut, të ishujve jonianë, të Italisë e të Dalmacisë. Megjithatë, edhe pasi sundimi osman mbi Morenë ishte vendosur plotësisht, në shek. XVI, udhëtarë të huaj dëshmojnë se Mani banohej nga shqiptarë që flisnin shqip e që refuzonin t’i nënshtroheshin pushtetit osman<sup>16</sup>. Nga ana e tij,

<sup>12</sup> S. Lambros, “Georgiou Gemistou eis Epitaphion Manuel tou Palaiologou”, në *Palaiologia kai Peloponnesiaka*, 3 Athinai: 1926, f. 4 vj.; Julian Chrysostomides, *Manuel II Palaiologus, Funeral Oration on his brother Theodore*, Tessalonike: 1985, f. 119 vj.

<sup>13</sup> P. Assenova, R. Stojkov, Th. Kaçorri, “Selistni lienii e familni omena ot severozapaden Peloponez prez sredata na XV vjek”, në *Godišnik na Sofijskija Universitet, Fakultet po Slavjanski Filologii*, tab. 68/3, Sofia: 1977, f. 213-297.

<sup>14</sup> N. Beldiceanu & J. Beldiceanu-Steinherr, “Corinthe et sa région en 1461 d’après le registre TT 10”, në *Südost-Forschungen*, 45, Leipzig: S. Hirzel, 1986, f. 41.

<sup>15</sup> Peter Schreiner, *Die byzantinischen Kleinchroniken*, vëll. I, Wien: Österreichische Akademie der Wissenschaften, 1975, f. 273.

<sup>16</sup> “*Le 6<sup>e</sup> (juin) vismes, à gauche le port delle Quaie, ainsy appellè à raison du nombre de cailles, qui se trouvent en la dicte contrée. Ce port est pres du susdict Capo di Matapan, auquel endroit le pays est nommè Brazzo di Maina, et les habitants Mainati, lesquelz jusques à present se sont garantis du joug du Turc; ils parlent albanois, et demeurent dans des cavernes ça et la par les montagnes ayant bruiet d’estre fort*”

më 1638, udhëtari osman Evlija Çelebi konstatonte se “banorët e krahinave që shtrihen nga Kalavrita, Voshtica e Tripolica deri në Korinth, janë shqiptarë që flasin shqip”<sup>17</sup>. Sipas një informatori francez, Mani kishte atë kohë një mijë fshatra e qytete me 100 mijë banorë dhe dispononte 12 mijë luftëtarë, shumica e të cilëve ishin shqiptarë<sup>18</sup>. Më 1690, kur vendin e shkretuar nga Lufta e gjatë Turko-Veneciane e kishin braktisur grupe të mëdha të popullsisë shqiptare, proveditori venecian Corner raportonte se në More kishte ende 1170 fshatra të banuara nga shqiptarë, të cilat, sipas tij, mund të nxirrnin 20123 luftëtarë të moshës 18-45 vjeç, pa përfshirë këtu edhe 4427 luftëtarët që nxirrte vetëm krahina luftarake e Manit<sup>19</sup>.

Në këto kushte, nuk habit fakti, që Peloponezi, e në veçanti krahina e tij skajore e Manit, u bë vatra që ushqe një pjesë të mirë të emigracionit shqiptar në kahun perëndimor, drejt ishujve të Jonit e më tej, drejt territoreve të Mbretërisë së Napolit, në Sicili e në Italinë e Jugut. Dokumentacioni mjaft i pasur venecian, na zbulon edhe mekanizmin që favorizoi zhvendosjen e elementit shqiptar nga viset shqiptare në ato greke, e më tej në ishujt e Jonit, në ato të Egjeut, në Dalmaci, Itali e gjithkund. Krijuesi i këtij mekanizmi ishte vetë Republika e Venedikut, e cila, siç del nga një letër e Marin Sanudos e vitit 1325, e kishte kuptuar se shqiptarët e emigruar në Greqi mund të ktheheshin në një aleat të fuqishëm të Republikës për të mbrojtur zotërimet e saj aty, fillimisht kundër sulmeve të katalanëve të dukatit të Athinës e Neopatrës, e kundër zotërve bizantinë të Thesalisë, e më vonë kundër vetë turqve osmanë<sup>20</sup>. Thelbin e këtij mekanizmi e zbulon qartë një dokument i vitit 1402, që

*belliqueux*”. Marrë nga: A. Vakalopoulos, *Istoria tou Neou Helenismou*, vëll. I, Tessalonike: 1961, f. 284.

<sup>17</sup> Hubert Pernot, *Introduction à l'étude du dialecte tsakonien*, Paris: 1934, f. 505; D. Zakythinis, *Le despotat grec de Morée ...*, vëll. II, f. 36.

<sup>18</sup> Demos N. Mekses, *E Mane kai oi Maniates*, Athinë: 1977, f. 34 (që citon nga: P. Kanellides, “Mane kai Maniatai”, në *Ebdomas*, f. 23, 4 korrik 1887).

<sup>19</sup> Sp. Lambros, “E peri Peloponnesou ekthesis tou Venetou pronoitou Corner”, në *Deltion tes Istorikes kai Ethnologikes Etairias tes Ellados (ΔΙΕΕ)*, 2, Athinai: 1885, f. 299.

<sup>20</sup> Gottlieb L. Tafel & Georg M. Thomas, *Urkunden zur älteren Handels-und Staatsgeschichte der Republik Venedig*, vëll. I, Hof und Staatsdruckerei, Wien: 1856, f. 495-501; Aldo Cerlini, “Nuove lettere di Marino Sanudo il Vecchio”, në *Bibliofilia*, 42, 1940, f. 348-354; “Albania graeca: përmasat e migrimeve shqiptare në Greqi në shek. XIV”, në Pëllumb Xhufi, *Arbërit e Jonit*, studime për Shqipërinë mesjetare, Tiranë: Pegi, 2006, f. 338, 349, 350.

bën fjalë për kolonizimin e Negropontit (Eubesë) me shqiptarët e ardhur aty nga Thesalia apo nga zotërimet e Dukatit të Athinës. Më 20 prill 1402, Senati i Venedikut merrte vendimin lidhur me “popullimin e ishullit tonë të Negropontit” (*pro apopulando insulam nostram Nigropontis*). Me atë rast, çdo shqiptar apo individ tjetër, që nuk ishte shtetas venecian, i cili brenda dy vjetësh nga dalja e atij vendimi dëshironte të vinte e të vendosej në atë ishull bashkë me familje, mund ta bënte këtë me privilegjin e përjashtimit të përhershëm nga çdo detyrim feudal apo shtetëror (*et sint et erunt perpetuo liberi et absoluti ab omni angaria reali et personali*). Për më tepër, ardhacakëve shqiptarë do t’u jepeshin edhe toka nga fondi publik, të papunuara por të afta për të prodhuar (*et sibi donabuntur de terrenis nostri comunis incultis, que tamen sint apta ad laborandum*)<sup>21</sup>. Çdo kryefamiljar duhet të ishte i pajisur me kalë, me të cilin duhej të paraqitej për mbrojtjen e ishullit sa herë që t’i kërkohej nga autoritetet veneciane. Nëse subjekti në fjalë vdiste, tokën dhe privilegjet bashkë me detyrimin ushtarak i trashëgonte i biri<sup>22</sup>. Në fakt, kjo masë dha rezultat të menjëhershëm, pasi në vitin 1425 në Negropont, nën nxitjen e autoriteteve veneciane, vazhdonin të hynin grupe të mëdha kolonësh shqiptarë.

<sup>21</sup> *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV* (më tej: *Acta Albaniae Veneta*), bot. G. Valentini, pars I, tomus 3, Rudolf Trofenik Verlag, München: 1967, nr. 949, f. 306; Freddy Thiriet, *Régestes des délibérations du Senat de Venise concernant la Roumanie*, vëll. II, Paris: 1959, nr. 1051, f. 26.

<sup>22</sup> “*Intellectis literis vestris, quibus nobis significastis, quod certa capita Albanensium ducaminis et diversorum locorum numero familiarum trecentarum intraverunt insulam et illam volunt habitare, quorum adventus videtur summe placere comunitati nostre Nigropontis...quod dicti tales Albanenses et alia gens equestris, teneantur tenere tot equos, quor homines capita familie erunt nunc, nec possint recedere de dicta insula sine licentia dicti Regiminis, sed teneantur et debeant omni vice qua erit necesse equitare et ire ad deffensionem insule, et offensionem quorumcumque volentium dannificare insulam nostram predictam*”. Dhe, me sa duket, kundrejt kësaj mase të madhe njerëzish, që sillnin me vete familjet, bagëtinë e çdo pasuri të tyre (*complures Albanenses... cum familiis, animalibus et aliis bonis suis*), qeveritarët venecianë të ishullit nuk munguan të tentojnë të nxjerrin fitimet e rastit, duke i ngarkuar kolonët e rinj me detyrime e angari arbitrare, gjë që solli reagimin e Senatit, i cili e urdhëroi qeveritarin e vet në Eube t’u kthente menjëherë shqiptarëve çdo pasuri, mall e të holla, që u ishte sekuestruar atyre padrejtësisht. *Acta Albaniae Veneta*, pars I, tomus 3, nr. 949, f. 306; F. Thiriet, *Régestes des délibérations du Senat ...*, vëll. II, nr. 1051, f. 26.

Ky është dokumenti i parë që na dëshmon lindjen e një figure emblematike në historinë e Ballkanit Perëndimor e të Evropës së shek. XIV-XVII, atë të “*stratitotit*” shqiptar<sup>23</sup>. Shumë shpejt, ky term u bë i ditës dhe shqiptarët filluan gjithnjë e më shumë të identifikoreshin me të. Me këtë sistem, kryesisht nga kolonët shqiptarë të vendosur në Greqinë kontinentale, Peloponez e ishuj në fund të shek. XIV, Venediku arriti të mobilizojë forca të shumta e të gjalla ushtarake që mbrojtën zotërimet e tij. Duke e vendosur shërbimin ushtarak si një kusht për të lejuar sistemimin në një territor nën juridiksionin e vet, venecianët, kontribuan së tepërmi në militarizimin e shoqërisë shqiptare dhe në orientimin e kolonizimit shqiptar drejt një kolonizimi ushtarak<sup>24</sup>. Fillimisht, veprimtaria kryesore e të ardhurve shqiptarë dëshmohej të ishte puna në bujqësi e blegtori. Një burim bizantin i shek. XV përshkruan se si emigrantët shqiptarë i shpyllëzuan, dhe i vunë nën kulturë vise të tëra të braktisura të Peloponezitet. I njëjti burim flet edhe për aftësitë e të porsaardhurve në blegtori, teksa përshkruan tufat e panumërta të lopëve, kuajve, deleve e derrave të blegtorëve shqiptarë të fushave të Elidës<sup>25</sup>. Por rrethanat e luftës në Greqi e Peloponez, të rënduara me shfaqjen e rrezikut turk, bëri që të ardhurit shqiptarë të orientoheshin gjithnjë e më shumë drejt ushtrimit të armëve. Qysh në vitin 1425, një vendim i Senatit të Venedikut sanksiononte, se “Shqiptarët duhet të na sigurojnë neve sundimin mbi gjithë Morenë si dhe të mbrojnë çdo zotërim tonin nga turqit e nga çdo armik tjetër”<sup>26</sup>. Gjithsesi, veprimtaria ushtarake e kolonëve shqiptarë të Moresë shoqërohej nga ajo e bujkut dhe jo gjithmonë këto dy veprimtari arrinin të harmonizoheshin me njëra-tjetrën. Në fakt, nuk mungojnë njoftime që tregojnë se si këta bujq-ushtarë

<sup>23</sup> Në fakt, *stratitotët*, si luftëtarë-bujq, ekzistonin edhe në shekujt e fundit të Perandorisë Bizantine, megjithatë pesha e tyre ishte e papërfillshme. Shih: Georg Ostrogorsky, *Quelques problèmes de l'histoire de la paysannerie byzantine*, Paris: 1956, f. 22vj.; Božidar Ferjančić, “Quelques significations du mot stratite dans les chartes de basse Byzance”, në *ZRVI*, 21, Beograd: 1982, f. 95-102; Angeliki Laiou-Thomadakis, *Peasant Society in the Later Byzantine Empire*, Princeton: 1977, f. 140, 142; David Jacoby, *La féodalité en Grèce médiévale. Les Assises de Roumanie*, Paris: 1971, f. 248.

<sup>24</sup> “Albania Graeca”: përmasat dhe pasojat e migrimeve shqiptare në Greqi në shek. XIV”, në Pëllumb Xhufi, *Dilemat e Arbërit*, Tiranë: Pegi, 2006, f. 364.

<sup>25</sup> S. Lambros, “Georgiou Gemistou eis Epitaphion Manuel tou Palaiologou ...”, f. 5, 40-42, 195; D. Zakythinis, *Le Despotat grec de Morée ...*, vëll. II, f. 32.

<sup>26</sup> Constantinos Sathas, *Documents inédits ou peu connus relatifs à l'histoire de la Grèce au Moyen âge*, vol. I, Paris: 1880, f. 176.

ndonjëherë braktisnin detyrën për t'u kujdesur për familjet e tyre<sup>27</sup>, ose për të punuar arat<sup>28</sup>.

Kur, duke filluar nga mesi i shek. XV, presioni i pushtuesve të rinj osman u bë i papërmbajtshëm, Republika e Venedikut u detyrua t'i dorëzojë këto zotërime dhe të shpërngulë shumë nga stratiotët shqiptarë, bashkë me familjet e tyre, në zotërimet e veta në Kretë, Qipro, Qefaloni, Zaçint, Korfuz, si dhe në zotërimet e tjera të saj në Shqipëri, Dalmaci e Itali. Jashtë Moresë, këto grupe kolonësh-ushtarë shqiptarë identifikoheshin sipas vendit të origjinës, si “shqiptarë koronej” (nga Korona), “shqiptarë modonej” (nga Modona), “shqiptarë napoletanë” (nga Nauplion) e “shqiptarë malvasiotë” (nga Malvasia, apo Monemvasia)<sup>29</sup>.

Dinamika e jashtëzakonshme që përfshiu elementin shqiptar në Greqi mes shek. XV-XVI, materializohet në mënyrë të koncentruar tek biografia e disa prej krerëve më të shquar shqiptarë të Moresë (Peloponezit). Kështu, në vitet 1470 një Krokodil Klada nga Korona shërbente për Venedikun në mbrojtje të kështjellës veneciane të Bardhunës e më tej asaj të Koronës, në krahinën e Manit<sup>30</sup>. Paqja e nënshkruar midis Venedikut e Portës pas dorëzimit të Shkodrës, më 1479, nuk u prit mirë nga kapiteni shqiptar, i cili atë vit ngriti flamurin e kryengritjes duke refuzuar t'i bindej Republikës e duke vazhduar të sulmojë garnizonet e karvanet turke në More. Me të u bashkuan edhe krerë të tjerë stratiotësh shqiptarë, si Teodor Bua e Meksha Buziki<sup>31</sup>. Në

<sup>27</sup> “non debbia ripossar suxo i Stratioti, perche a questo ponto gran parte de quelli si ritrasse di campo, zioè Albanexi per andar a guardar le loro fameie et remaxeno pochi in campo”, Constantinos Sathas, *Documents inédits relatifs á l'histoire de la Grèce au Moyen âge*, vol. VI, Paris: 1885, f. 14.

<sup>28</sup> “lassar essi Stratioti a tagliar et recoglier le sue biave”, “i detti Stradioti, lavorando i terreni”, C. Sathas, *Documents inédits ...*, vëll. VI, f. 133, 159.

<sup>29</sup> S. Lambros, “Metanasteusis Ellenon idios Peloponnesion apoikon eis to Basileion tes Neapoleos”, në *Neos Ellenomnemon*, tomos II: 31 dicembris 1911, teuchos 4, Athens: 1911, f. 413-414, 441-442 (*Albanesi Coronei*); ASV, *Sen. Mar.*, f. 30: 29 qershor 1564 (*Napoletani, Malvasioti*); ASV, *Sen. Mar.*, filza 58: 10 prill 1574 (*Albanesi Napolitani et Medonei*).

<sup>30</sup> Për Krokodil Kladden e stratiotë të tjerë shqiptarë në Peloponez, shih: C. Sathas, *Documents inédits ...*, vol. I, f. XXII; *po aty*, vol. V, Paris: 1984, f. 31, 152; *po aty*, vol. VI, f. 120, 129, 211, 237, 244, 153; Franz Babinger, “Albanische Stratioten im Dienste Venedigs”, në *Studia Albanica*, nr. 2, Tiranë: 1964, f. 101 e vijim. Nga relacioni i Jakob Barbarigos, 1465, mësojmë se komandant i kështjellës së Bardhunës atë kohë ishte Epifan Klada (C. Sathas, *Documents inédits ...*, vol. VI, 48).

<sup>31</sup> C. Sathas, *Documents inédits ...*, vol. VI, f. 148, 159.

përputhje me klauzolat e paqes, turqit i kërkuan autoriteteve veneciane të Koronës që ta dënonin stratiotin rebel. Senati i Venedikut vendosi, më 8 janar 1480, që Klada të shpallej armik, të shtihej në dorë nga qeveritari i Koronës dhe të ekzekutohej<sup>32</sup>. Në fakt, ai që u zu rob nga qeveritari venecian i Malvasisë ishte Teodor Bua<sup>33</sup>, ndërkohë që Krokodil Klada bashkë me familjen e tij arriti të arratisë e të vendosej në Mbretërinë e Napolit, rivale e Venedikut. Bashkë me shumë krerë të tjerë shqiptarë, Klada luftoi për mbrojtjen e Otrantos nga sulmet osmane. Në pranverën e vitit 1481 pozita e forcave osmane të angazhuara në ekspeditën e Otrantos, ishte vështirësuar, e në verën e atij viti Mbreti i Napolit dërgoi në brigjet e Vlorës, Gjon Kastriotin, djalin e Skënderbeut, në mbështetje të një kryengritjeje antiosmane që kishte shpërthyer ndërkohë në trevën e Kurveleshit e të Himarës. Bashkë me Gjon Kastriotin, në këtë ekspeditë Mbreti Ferdinand dërgoi edhe një kushëri të Gjonit, Kostandin Muzakë Karlin, si dhe Krokodil Kladan e Koronës, që, siç u tha, ndonjë vit më parë kishte ardhur në Napoli nga Mani i Moresë (*etiam mandò Clade de Coron, el qual era fugido dal Brazo de Maina*)<sup>34</sup>. Dihet që me atë rast, forcat kryengritëse çliruan rreth 50 fshatra të asaj treve, dhe më 31 gusht ato morën edhe kështjellën e Himarës e zunë rob Sulejman Beun e Vlorës. Por, aty e ndonjë vit më vonë, efektet e kësaj fitoreje u zbehën dhe gjatë një beteje pikërisht në Himarë, Krokodil Klada u zu rob dhe u bë copë-copë nga turqit<sup>35</sup>. Për shërbimet e tij, Krokodil Klada u shpërblye nga Mbreti Ferdinand me titullin “*magnificus*” dhe një pension prej 300 dukatësh<sup>36</sup>.

Një familje më të madhe e më të njohur se ajo e Krokodil Kladës, përfaqësonte shoku i tij i armëve në kryengritjen e vitit 1479 në

<sup>32</sup> C. Sathas, *Documents inédits ...*, vol. I, f. 273-274.

<sup>33</sup> C. Sathas, *Documents inédits ...*, vol. VI, f. 180.

<sup>34</sup> “*quello insieme con un suo cusin et molti Albanesi havea con lui, homeni valenti, mandò con alcune galie dell’armata sua Regia in ditte parte, con le qual etiam mandò Clade de Coron, el qual era fugido dal Brazo de Maina*”, C. Sathas, *Documents inédits ...*, vol. VI, f. 229; Injac Zamputi, *Dokumenta të shekullit XV për historinë e Shqipërisë*, vëll. 4 (1479-1506), pj. I (1479-1499), Tiranë, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, 1967, f. 70.

<sup>35</sup> “*detto Capitano Concordilli fù daTurchi tagliato à pezzi alla Cimera*”, ASV, *Sen. Mar*, filza 25: memorial i Teodor Kladas, 18 dhjetor 1561; K. Sathas, *Ellenika Anektdota*, vëll. I, Athinë: 1867, f. LV.

<sup>36</sup> I. Zamputi, *Dokumente të shek. XV për historinë e Shqipërisë ...*, vëll. IV, pj. I (1479-1499), f. 70.

Peloponez, Teodor Bua. Sipas një njoftimi të nëntorit 1480, Teodor Bua u rebelua ndaj autoriteteve veneciane dhe bashkë me disa besnikë të tij iku në Argos, ku zuri rob një numër ushtarësh turq që punonin tokën. Prej andej, Teodori ia mbajti në krahinën e Manit, ku u bashkua me Krokodil Kladden e të dy së bashku turbulluan paqen e Venedikut me Sulltanin<sup>37</sup>. Grupit të tyre iu bashkua edhe kreu tjetër i stratiotëve, Meksha Buziqi. Venediku dërgoi stratiotë të tjerë për t'i zënë e për t'i sjellë të lidhur, por këta u kthyen mbrapsht, duke u justifikuar se “nuk donin ta bënë një gjë të tillë, pasi ishin të një kombësie me kryengritësit” (*excusandose non li haver possuto prender, e questo per esser de una nation non li ha voluto prender*)<sup>38</sup>. Ndonëse familjet e tyre mbaheshin peng, Teodor Bua e Meksha Buziqi, siç raportonte qeveritari venecian, “vazhduan të rrëmbejnë e të vrasin turq e shtetas turq, që janë miq e fqinjët tanë, duke rrezikuar me këtë sjellje paqen mes nesh”<sup>39</sup>. Gjendja duket se u përmirësua për venecianët dhe për marrëdhëniet e tyre me osmanët, kur, gjatë një përleshjeje, Teodor Bua u zu rob nga Podestà i Monemvasisë<sup>40</sup>. Përveç Teodorit, burimet veneciane përmendin krerë të tjerë nga kjo familje, si Pirro e Gjin Buan, madje edhe një kushëri të islamizuar të tyre, Hamza Buan (*Cacamusa Bua Turco, zerman cusin deli spectabili Piro e Ghini Bua*)<sup>41</sup>. Prej kësaj familjeje bëri emër më vonë edhe Pjetër Bua, i cili në vitin 1559 fitoi një post të rëndësishëm në administratën veneciane të Korfuzit, kurse në vitin 1571 u mbush me lavdi në betejën e famshme të Lepantos<sup>42</sup>. Akoma më i njohur se Pjetri ishte i afërmi i tij, Mërkur Bua. Në krye të një trupe kalorësish stratiotë shqiptarë (*capitaine de cent hommes de guerre à cheval albanays*), siç shprehet në një deklaratë të shkruar nga ai vetë më 17 qershor 1506<sup>43</sup>, Merkur Bua u angazhua në shërbim të disa shteteve evropiane, duke filluar nga Republika e

<sup>37</sup> C. Sathas, *Documents inédits...*, vëll. VI, f. 148.

<sup>38</sup> *Po aty*, f. 175.

<sup>39</sup> “*non cessa a la giornata de predar et amazar Turchi et suo subditi, nostri amici e vicini, con la deturbation de la pace*”, *po aty*, f. 175.

<sup>40</sup> *Po aty*, f. 180.

<sup>41</sup> *Po aty*, f. 84.

<sup>42</sup> Émile Legrand, *Bibliographie hellénique, ou description raisonnée des ouvrages publiés en grec par des Grecs aux XV<sup>e</sup> et XVI<sup>e</sup> siècles*, vol. I, Paris: Ernest Leroux éd., 1885, f. CCV.

<sup>43</sup> *Po aty*.

Venedikut, Mbretëria e Spanjës, ajo e Francës, e duke mbaruar me Papatin e me vetë Perandorinë Gjermane<sup>44</sup>.

### Nga Morea drejt fronteve të tjerë

Paqja e vitit 1479 me Perandorinë Osmane i mundësoi Venedikut të largojë nga Morea njësi stratiotësh e t'i zhvendosë ata në zotërimet e tjera, që kishin nevojë të përforcoheshin me trupa shtesë. Kështu, me rastin e ekspeditës osmane të Otrantos, që u nis nga baza e Vlorës, Senati iu tremb një sulmi të mundshëm kundër Durrësit venecian, ndaj më 22 shtator 1480 vendosi të zhvendosë drejt këtij qyteti nga Korona e Moresë 300 stratiotë shqiptarë nën komandën e kapitenit Dhimitër Bokali<sup>45</sup>. Përforcime me trupa kërkoheshin atë kohë edhe në ishujt e Jonit. Në vitin 1487, kërkoheshin të silleshin në Zaçint rreth 400 kolonë të rinj, të cilët duhet të ishin të aftë për luftë, pra, të ishin stratiotë. Ashtu si kolonëve shqiptarë të Negropontit më 1402, edhe këtyre stratiotëve, Venediku u ofronte "*terrena ad culturam pro alimento eorum ac familiarum*" (toka të punueshme, me të cilat të ushqehen ata vetë dhe familjet e tyre). Nga ana tjetër, stratiotët-kolonë siguroheshin se nuk do t'i dorëzonin më fiskut venecian detyrimin e së dhjetës (*absque angaria contribuenda dominio decimam aliquam*) dhe, në fund, për ata muaj të vitit kur do kryenin shërbim ushtarak, ata do të paguheshin me tre dukata në muaj.<sup>46</sup>

Në vitet 1499-1503, Republika e Venedikut hyri në luftë me Portën e Lartë dhe zotërimet e saj në More u bënë një teatër luftimesh të ashpra. Në korrik 1500, trupat osmanë morën me sulm kështjellën e Modonës, një nga bazat kryesore të sundimit venecian në Peloponez e në gjithë Lindjen<sup>47</sup>. Më 16 gusht u dorëzua tek turqit edhe baluardi tjetër venecian në Man të Peloponezit, Korona e më tej Xonkio<sup>48</sup>. Më herët, venecianët kishin humbur Lepanton e Qefaloninë. Këtë ishull të fundit të Jonit

<sup>44</sup> P. Petta, *Stradioti, soldati albanesi in Italia (sec. XV-XIX) ...*, f. 100.

<sup>45</sup> Pak më vonë ky u plagos gjatë një beteje me turqit afër Krujës, shih: C. Sathas, *Documents inédits relatifs à l'histoire de la Grèce au Moyen Âge*, vol. VII, Paris: 1888, f. 24.

<sup>46</sup> I. Zamputi, *Dokumenta të shekullit XV ...*, vëll. 4, pj. I (1479-1499), f. 102.

<sup>47</sup> Gaetano Cogo, "La guerra di Venezia contro i Turchi (1499-1503)", në *Nuovo Archivio Veneto*, 18/1-2, Venezia: 1899, f. 374-379; Alberto Tenenti, "I corsari in Mediterraneo all'inizio del Cinquecento", në *Rivista Storica Italiana* LXXII, 1960, f. 251.

<sup>48</sup> Marino Sanudo, *Diarii*, vol. III, Venezia: Forni Editore, 1880, col. 770.

Republika ua rrëmbeu përsëri turqve, më 24 dhjetor 1500, falë ndihmës së flotave spanjolle, napoletane, franceze e papale<sup>49</sup>. Vetëm pas pak ditësh, më 18 janar 1501, Senati mori vendimin që në atë ishull të silllej me urgjencë një numër sa më i madh stratiotësh nga Morea<sup>50</sup>. Mbi bazën e atij vendimi, gjatë gjithë gjysmës së parë të shek. XVI, nga krahina e Manit erdhën e u vendosën në Qefaloni shumë familje stratiotësh. Kështu, më 1535 tre stratiotë shqiptarë, Gjon Kutuvali, Donato Peta e Gjon Snati, pasi i kishin shërbyer Venedikut në Modonë, u lejuan të vendosen në Qefaloni, siç e kishin kërkuar vetë, ku do t'u jepeshin toka për të punuar<sup>51</sup>. Prej Modonës u shpërngulën në Qefaloni edhe stratiotët e familjes Këmbëthekra (*Cambotechra*)<sup>52</sup>. I pari i tyre në vitin 1548 ishte Andrea, kapiten stratiotësh (*capo stratioti*)<sup>53</sup>. Dy djemtë e tij, Aleksandri dhe Nikolla, si dhe një Helia Këmbëthekra, me siguri i afërm i tyre, shërbyen gjithashtu si kapitenë stratiotësh në Qefaloni, në vitet 1550<sup>54</sup>. Në vitin 1568, Andruco Këmbëthekra shërbente në atë ishull me një kompani prej 50 stratiotësh<sup>55</sup>. Pinjollë të familjeve Lëkurësi (*Licuressi*), Fuga (*Fuca*), Frassina, Bineri (*Vineri*), Kokla, Galanxhi (*Calenci*), Vllami (*Valami*), Kasneci, Snati, Bua, Barbati si edhe pinjollë të familjeve Reçi, Dajçi (*Daiça*), Kelmendi, që pas çdo gjase vinin nga Shqipëria e Epërme, kishin lënë Modonën, Koronën, Nauplionin e

<sup>49</sup> *Po aty*, col. 1272-1277; G. Cogo, "La guerra di Venezia contro i Turchi ...", f. 406-407.

<sup>50</sup> "vadano a stantiar alla Cephalaria, siccome hanno ricercato per habitar più che si può quell'isola nostra con darli di quelli terreni che si suoleno dare a quelli vanno ad habitare de li, juxta la parte del 1501 adì 18 genaro", ASV, *Sen. Mar*, reg. XXIII, f. 91, 92.

<sup>51</sup> "vadano a stantiar alla Cephalaria, siccome hanno ricercato per habitar più che si può quell'isola nostra con darli di quelli terreni che si suoleno dare a quelli vanno ad habitare de li, juxta la parte del 1501 adì 18 genaro", ASV, *Sen. Mar*, reg. XXIII, f. 91, 92.

<sup>52</sup> ASV, *Senato Mar*, filza 32: në Senat, 2 qershor 1565.

<sup>53</sup> ASV, *Senato Mar*, filza 5, fol. 552<sup>r</sup>: në Senat 27 prill 1548.

<sup>54</sup> ASV, *Senato Mar*, filza 5, fol. 552<sup>r</sup>: në Senat 27 prill 1548; ASV, *Senato Mar*, filza 8, fol. 312<sup>r</sup>: në Senat 21 nëntor 1551; ASV, *Senato Mar*, filza 5, fol. 551<sup>r</sup>: në Senat 27 prill 1548. Në vitin 1578 flitet për një djalë të Aleksandër Këmbëthekrës, Benetin, i cili ishte shquar për trimëri gjatë luftës së fundit me turqit (1571) dhe që atëherë ishte kapiten i një kompanie me 50 kalorës në Qefaloni. Shih: ASV, *Senato Mar*, filza 71: në Senat, 10 maj 1578.

<sup>55</sup> "io Andruzo Combotechra...fiol del Capitano Alessandro suo capo de cavalli 50 destinato alla custodia della Ceffallonia", ASV, *Senato Mar*, filza 39: në Senat, 3 korrik 1568.

Monemvasinë (Malvasinë) duke u strehuar në ishujt e Jonit, në Qefaloni e Zaçint, prej nga ku shumë prej tyre e vijuan odisenë e tyre si ushtarakë në shërbim të Venedikut apo të Napolit sa në Dalmaci, aq edhe në Itali<sup>56</sup>. Prurjet e refugjatëve shqiptarë në ishujt e Jonit në zotërim të Venedikut, vazhduan edhe në dekadat e mëvonshme. Më 25 qershor 1615 dogji Memo e porosiste proveditorin Grimani, që të tregonte kujdes ndaj refugjatëve që mbërrinin në ishujt jonianë nga Mani i Moresë: nëse ishin në numër të kufizuar, të përpiquej t'i sistemonte. Por, nëse numri i tyre ishte i madh, t'i niste fshehurazi drejt vendeve të tjera, gjasisht drejt Italisë së Jugut<sup>57</sup>. Atë kohë Republika po shijonte një paqe të gjatë me Perandorinë Osmane dhe kërkesa për stratiotë shqiptarë kishte rënë dukshëm.

Përsa i përket Korfuzit, aty ishte dislokuar një kompani stratiotësh nga Nauplion e nga Modona, që të gjithë shqiptarë (*tutti Albanesi Napolitani et Medonei*), të cilët u shquan në luftimet e zhvilluara me turqit osmanë në vitet 1571-1572 sa në Korfuz, aq edhe në Sopot (Borsh) e Margëlliç të Arbërisë së Poshtme<sup>58</sup>. Në vitin 1545, Gjergj Buziqi (Zorzi Busichio), që dikur kishte qenë komandant stratiotësh në Nauplion, shërbente në Korfuz në kompaninë e të vëllait, *Repossi Busichio*<sup>59</sup>. Aleks Kambera ishte më 1558 komandant i një kompanie prej 15 stratiotësh

<sup>56</sup> ASV, *Senato Mar*, reg. 22, fol. 152<sup>r</sup>: në Pregadi, 28 gusht 1532 (*Andrea Licuressi, Pietro Frassina*); ASV, *Senato Mar*, filza 70: në Senat, 4 nëntor 1577 (*Fuca, Vineri*); ASV, *Senato Mar*, filza 39: në Pregadi, 8 maj 1568 (*Bitri Cocla, quondam Gigni da Malvasia*); ASV, *Senato Mar*, reg. 15, fol. 87<sup>v</sup>: në Pregadi, 3 korrik 1501.

<sup>57</sup> “*ma se qualcuno si ricovrasse, mostrar di non avvedersi et essendovi passati in numero considerabile, sieno segretamente licenziati*”, Injac Zamputi, *Dokumente të shek. XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, vëll. III (1603-1621), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: 1989, f. 323.

<sup>58</sup> “*è à tale termine redutta la sua povera stratia de Corphu tanto valorosa et sua benemerita quanto gli è noto poiche sono tutti Albanesi Napolitani et Medonei che per la sua fidelità hanno voluto lassar la patria et beni loro, et ne la passata guerra turchesca hanno fatto tal servitù che si fussero stati 500 più non haverebbero fatto poi che pochissimi fecero strapazzo grandissimo de Turchi quali in tutte le isole mettendo l'armata in terra dismantavano senza cavalli 23 in Candia, Zante et Zaffalonia et à Corphù mai ossorno dismantar per il gran travaglio c'havevano da ditta cavallaria salvo quando ricondussero cavalli 800 con quali la sua stratia combatete a S. Rocho valorosamente et con tutti gli altri de l'armata sempre è stata la prima à combater si ne le isole di Corphù, Margaretin, Sopotò et ogni altro loco come sano gli suoi Cl.mi generali, proveditori, Baili et Capitani*”, ASV, *Sen. Mar*, filza 58: 10 prill 1574.

<sup>59</sup> ASV, *Senato Mar*, reg. 28, fol. 80<sup>v</sup>: 24 shtator 1545.

shqiptarë të ngarkuar me ruajtjen e Korfuzit (*alla custodia dell'isola nostra di Corfù*)<sup>60</sup>. Një tjetër komandant stratiotësh shqiptarë, *Zorzi Barbati*, më 1597 zëvendësoi Spiro Barbatin, vëllain e tij, në drejtimin e një stratie në Korfuz<sup>61</sup>. Barbatët kishin ardhur në Korfuz nga Korona e Manit (More)<sup>62</sup>. Me sa duket, Korfuzi nuk ishte stacioni i fundit e i vetëm i barbatëve të Moresë. Vincenzo Dorsa na kumton se familja Barbato rezulton të jetë ndër familjet themeluese të Piana degli Albanesi (Palermo, Sicili)<sup>63</sup>.

Më 1576, bajliu venecian, Fabio da Canale, raportonte se mbrojtjen e Korfuzit ia kishte besuar një reparti me 50 stratiotë, të komanduar nga kapiteni Muzaka<sup>64</sup>. Ky duhet të jetë i njëjtë me kapitenin *Tomaso Musachi*, i cili pas disa vitesh komandonte në Korfuz 65 stratiotë, “*tutti valorosi soldati et molto fidelissimi*”<sup>65</sup>.

Përpos njësive të stratiotëve të ardhura nga Morea, në Korfuz regjistrohet vazhdimisht një prani e madhe e popullsisë shqiptare, e cila ushqejë sistematikisht nga refugjatë që vinin nga brigjet e sanxhakut të Delvinës. Më 25 shkurt 1616, proveditor-kapiteni venecian, Antonio Ciurano, i raportonte Senatit se në ishull numëroheshin rreth 4 mijë shqiptarë. Atë vit në Korfuz kishin ardhur nga brigjet përballë grupe të tëra shqiptarësh, “të cilët i kishin sjellë atij vendi një dobi shumë të madhe, duke kultivuar tokat e lëna djerr dhe duke kryer punë të tjera me vlerë”<sup>66</sup>.

<sup>60</sup> ASV, *Senato Mar*, reg. 34 (1558-1559), fol. 46<sup>v</sup>: 22 tetor 1558.

<sup>61</sup> ASV, *Senato Mar*, reg. 57, fol. 11<sup>r</sup>: 31 mars 1597.

<sup>62</sup> S. Lambros, “Metanasteusis Ellenon idios Peloponnesion apoikon eis to basileion ...”, f. 456. Megjithatë, më 1537 gjejmë një pinjoll të Barbatëve, që shërbente në Korfuz, por ishte me origjinë nga Nauplion (*Gianni Barbati da Napoli di Romania*), shih: ASV, *Sen. Mar*, filza 5, fol. 178<sup>rv</sup>.

<sup>63</sup> Vincenzo Dorsa, *Su gli Albanesi. Ricerche e pensieri*, Napoli: tipogr. Trani, 1847, f. 74.

<sup>64</sup> “*haber alla custodia di quell'isola cinquanta cavalli levantini...la qual strattia è stata retta ed disciplinata nel mio reggimento dal fedelissimo cavalla Musacchi suo governatore*”, Gerasimos D. Pagkrates, *Oi ektheseis ton Veneton bailon kai pronoeton tes Kerkyras (16 aionos)*, Instituto Byzantinon Ereunon, Athinë: 2008, f. 172.

<sup>65</sup> *Ibid.* Disa vjet më vonë, kjo trupë përbëhej nga 77 kalorës të udhëhequr nga 4 kapitenë shqiptarë dhe një guvernator i quajtur Nikollë Vllami: “*un governor et 4 capitani Albanesi con 77 cavalli, compresi i regazzi, il governor è Nicolò Vlami*”, G. D. Pagkrates, *Oi ektheseis ton Veneton bailon tes Kerkyras ...*, f. 221.

<sup>66</sup> “... senza toccar punto gli Albanesi, i quali sono circa à quattromille anime, et questo anno ne sono molte famiglie venute ad habitar quà, colche ne riceve questa isola un

Por, ashtu si në Qefaloninë fqinje, edhe në Korfuz venecianët vendosën ta reduktojnë në minimum numrin e stratiotëve shqiptarë kur tensionet me Portën kishin arritur pikën e tyre më të ulët. Kështu, në vitin 1638, proveditor-kapiteni i Korfuzit merrte urdhër nga Senati, që të mos pajtonte stratiotë të rinj e të mos zëvendësonte të vdekurit. Në këtë mënyrë, arsyetonte Senati, duke u zvogëluar, kjo trupë “një ditë do të shuhej vetë” (*In maniera che sempre diminuendosi essa soldatesca, alla fine cadesse da se stessa*)<sup>67</sup>.

Përtej rastit të Krokodil Kladas nga Korona e Mani e të tjerëve si ai, që përfunduan në Mbretërinë e Napolit pas konflikteve që patën me qeveritarët venecianë të Moresë, ishte vetë Republika e Venedikut që i hapi rrugë vendosjes së organizuar të stratiotëve shqiptarë në territoret e asaj mbretërie. Kjo ndodhi me rastin e fushatës së vitit 1494 të Mbretit Karli VIII i Francës në Italinë e Jugut. Venedikasit, të cilët deri atëherë kishin patur marrëdhënie konfliktuale me shtetet e tjera italiane, aq sa akuzoheshin si “*auctores malorum Italiae*” (shkaktarë të fatkeqësive të Italisë)<sup>68</sup>, kësaj here u bashkuan me aragonezët e Napolit e aleatët e tyre për të ndalur vërshimin e francezëve drejt brigjeve të Adriatikut, ku prekeshin drejtpërsëdrejti interesat e Republikës. Për kontributin që dhanë në zbrapsjen e ofensivës së Karlit VIII, venecianët u shpërblyen nga Mbreti Ferdinand i Napolit me dhurimin e qendrave bregdetare të Monopolit, Polignanosit, Molas, Tranit, Brindisit, Otrantos, të cilat qëndruan për disa vjet nën juridiksionin venecian<sup>69</sup>. Aty, me urdhër të Senatit u sollën shumë kompani stratiotësh nga Morea, ku në vitin 1500 turqit kishin pushtuar Koronën, Modonën e kështjella të tjera veneciane. Ndër kapitenët shqiptarë që vinin nga Morea e ishujt e Jonit, apo që ishin

*notabilissimo servitio per la quantità de terreni che riducono à coltura et per altre buone opere, che fanno, e spero che ogni giorno più si veniranno ad accasare per il buon trattamento che loro vien fatto, et l'utile che cavano dal lavorar la terra*”, ASV, *Dispacci Corfù*, b. 10 (1615-1616): raport nga Korfuzi i proveditor-kapitenit Antonio Ciurano, 25 shkurt 1616.

<sup>67</sup> ASV, *Dispacci Corfù*, b. 19 (viti 1635-6): raport i proveditor-kapitenit Pietro Loredano, Korfuz, 2 shkurt 1638.

<sup>68</sup> ASV, *Sen. Mar.*, b. 35, c. 28: 24 shtator 1494.

<sup>69</sup> Giovanni J. Cassandro, “Contributo alla storia della dominazione veneta in Puglia”, në *Archivio Veneto*, Real Deputazione di Storia Patria per le Venezie, anno LXV, 5 serie, nr. 33, Venezia: 1935, f. 13; Pëllumb Xhufi, *Arbërit e Jonit. Vlora, Delvina e Janina në shekujt XV-XVII*, Tiranë: Onufri, 2017<sup>2</sup>, f. 287.

të vendosur prej kohësh në Mbretërinë e Napolit, ishte edhe Gjon Muzaka, i cili në vitin 1502 kryente detyrën e admiralit (*amiraro*) të Brindisit për llogari të Republikës<sup>70</sup>.

Pas përfshirjes së saj në perandorinë e Karlit V, Mbretëria e Napolit, tashmë me statusin e mbretërisë-bijë (nënmbretëri), mori rolin e një avamposti të Evropës katolike në përplasjet me Perandorinë Osmane, kufijtë e së cilës nisnin në bregun lindor të Adriatikut<sup>71</sup>. Për gati një shekull, spanjollët u përpoqën të nxisin në Shqipëri e More kryengritje të armatosura, të kryenin akte sabotazhi e të thurnin një rrjet të gjerë informatorësh<sup>72</sup>. Duke filluar nga viti 1530, në krye të këtyre veprimtarive ishte emëruar Alfonso Kastriot Vranaj, markez i Atripaldës e nip i Skënderbeut. Një zgjedhje e tillë është dëshmi e faktit që spanjollët e Napolit i llogarisnin shqiptarët, qofshin ata që ndërkohë ishin sistemuar në territoret e mbretërisë së Napolit, qofshin ata që vazhdonin të popullonin vendet e Ballkanit Perëndimor, si faktor kryesor për veprimet e tyre në ato anë. Këtë e impononte jo vetëm prania e tyre e madhe, nga Gjiri i Kotorrit në Peloponez, por edhe shpirti luftarak që ata kishin dëshmuar me kryengritjet e tyre të pareshtura kundër sundesve osmanë. Jo më kot, humanisti italian Francesco Filelfo deklaronte se shqiptarët ishin i vetmi komb që i kishte bërë ballë turqve<sup>73</sup>. Në këto kushte, zgjedhja e markezit të Atripaldës, nip i Skënderbeut, ishte edhe një dëshirë e shqiptarëve. Në letrën e tyre të 14 gushtit 1532, krerët e Himarë-Labërisë informonin markezin se “populli i asaj ane, të mëdhenj e të vegjël, u gëzuan kur morën vesh se Zotëria Juaj jeni shqiptar”<sup>74</sup>. Edhe pas Alfons Kastriot Vranas, më 1571, roli i tij u mor përsipër nga

<sup>70</sup> M. Sanudo, në: Injac Zamputi, *Dokumente për Historinë e Shqipërisë 1479-1506*, pj. II (1499-1506), Tiranë: 1979, f. 324.

<sup>71</sup> Peter Bartl, *Der Westbalkan zwischen spanischer Monarchie und osmanischem Reich*, Wiesbaden: Otto Harrassowitz, 1974, f. 37 vijim.

<sup>72</sup> *Po aty*, f. 38; P. Xhufi, *Arbërit e Jonit ...*, f. 1107-1114.

<sup>73</sup> “*soli ex omnibus nationibus intra Istrum et Hadriam ad Italiae fines et fortissime Turcos semper substinuerunt*”, Odorico Rinaldi, *Annales Ecclesiastici ab anno MCXVIII*, bot. J. D. Mansi, vëll. X, Lucca: Leonardo Venturini, 1753, f. 365; Fan Noli, “Histori e Skënderbeut”, në *Vepra 4*, përg. bot. P. Bogdani, Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, Tiranë: 1989, f. 235.

<sup>74</sup> “*li havemo facto cognoscere como la Signoria Vostra è Albanese, de questo sta più gaudente lo paese et piccoli et grandi*”, José M. Floristan, “Los contactos de la Chimarra con el Reino de Napoles”, në *Erytheia*, 11-12, Madrid: 1990-1991, f. 122-123, 133-134.

një tjetër shqiptar, kësaj here nga diaspora e Moresë, kapiten Jeronim Kombi. Kombi i përkiste atyre familjeve të stratiotëve shqiptarë nga Monemvasia dhe nga Nauplion (Napoli di Romania), që më 1541 u transferuan prej venecianëve nga Morea në Qipro, ku u pajisën me toka dhe u ngarkuan me mbrojtjen e ishullit<sup>75</sup>. Pas pushtimit të Qipros nga turqit, më 1570, Kombi kaloi në shërbim të spanjollëve bashkë me 200 kalorës të rekrutuar në Shqipëri. Me ta, Kombi kreu misione të ndryshme në Milano, Savoia, Ferrara, Piemonte si dhe “në Himarën e Shqipërisë” (*en la Cimarra de Albania*)<sup>76</sup>. Nën urdhrat e tij ishin kapitenët Nikolla Renësi, Gjon Golemi, Pal Karuka, Dhimitër Golemi, Stefan Krizia (Kryeziu), Gjon Skura, Gjon Plesha, Guljelm Arianiti, Mihal Bua, Zef Muzaka<sup>77</sup>. Më 1592, Kombi në krye të stratiotëve të tij u dërgua në ndihmë të Papës, në Romë, ku arriti të rivendosë rendin në qytetin e dëmtuar rëndë nga trazirat<sup>78</sup>. Më tej, Kombi u ngarkua me detyrën delikate, që kishte kryer para tij edhe Alfonsi, markez i Atripaldës. Burimet e kohës e cilësojnë atë si “kreun e zbuluesve...që organizon çdo aksion që kryhet në Shqipëri” (*capo delle spie...per le mani del quale passano tutti i maneggi di Albania*)<sup>79</sup>. Kombi ishte personi që priste të ikurit shqiptarë nga brigjet lindore të Adriatikut e Jonit, shumë prej të cilëve ai i organizonte dhe i niste me misione ushtarake apo misione zbulimi në Shqipëri e në Greqi. Është mbresëlënës fakti, që ky personazh kozmopolit, i lindur dhe i rritur larg Shqipërisë, njëlloj si i sipërpërmenduri markez i Atripaldës, deklaronte se ishte “shqiptar” dhe patriot i Gjergj Kastriot Skënderbeut<sup>80</sup>. Mbreti i Napolit e preferoi atë për misionet e zbulimit në Shqipëri e Greqi, pasi, siç thuhet në një dekret të

<sup>75</sup> “...l’anno 1541 fu dato ordine et conces so per parte presa nell’Ill.mo Senato a questo Regimento, che a Napoletani et Malvasioti fussero assignati tanti terrenida publico in questo Regno”, ASV, Sen. Mar, filza 30: 29 qershor 1564.

<sup>76</sup> José M. Floristan, *Fuentes para la politica oriental de los Austrias: la documentation griega del Archivo de Simancas (1571-1621)*, vëll. I, Leon: Universidad de Leon, 1988, f. 94, shën. 48; P. Xhufi, *Arbërit e Jonit ...*, f. 705.

<sup>77</sup> P. Bartl, *Der Westbalkan zwischen spanischer Monarchie ...*, f. 151, shën. 27.

<sup>78</sup> José M. Floristan, “Jeronimo Combis, capitan de estradiotes y superintendente general del servicio español de espionaje en Napole”, në *Erytheia* 36, Madrid: 2015, f. 179, 180.

<sup>79</sup> J. Tomić, *Graća za istoriju pokreta na Balkanu protiv Turaka krajem XVI I početkom XVII veka*, vol. I, Beograd: Srpska Kraljevska Akademija, 1933, f. 703.

<sup>80</sup> J. M. Floristan, “Jeronimo Combis, capitan de estradiotes ...”, f. 186, 187; P. Xhufi, *Arbërit e Jonit ...*, f. 704, 706.

tij, “ai njihete gjuhën greke dhe atë shqipe, të cilat edhe i shkruante”<sup>81</sup>. Në një memorial të vitit 1619 për Mbretin e Spanjës, Jeronim Kombi evokon shërbimet e mëdha që i kishin bërë shqiptarët Kurorës së Spanjës, e sidomos “në kohën e princit Skënderbe, kur u hodhën me anije në territoret e asaj mbretërie dhe marshuan drejt Barletës për të liruar Mbretin Ferrante nga rrethimi i armiqve të tij francezë”<sup>82</sup>. Kujtojmë se më 1557, një farë Gjon Herakli, edhe ai shqiptar nga Morea, në një letër për Mbretin e Napolit i referohet me krenari Gjergj Kastriot Skënderbeut, madje duke pretenduar se ishte kushëri i tij<sup>83</sup>. Shembujt tregojnë, se të paktën në elitën shqiptare të diasporës shqiptare në Greqi, figura e Skënderbeut ishte mjaft e njohur, edhe pse emigracioni shqiptar në Greqi i përkiste fundit të shek. XIV dhe nuk e kishte përjetuar epokën e Gjergj Kastriot Skënderbeut.

Pas shek. XVI, Mbretëria e Napolit, bijë e asaj të Spanjës, duket se e kaloi Venedikun në rekrutimin e luftëtarëve shqiptarë. Praninë e këtyre në strukturat ushtarake të mbretërisë e dëshmon një mbishkrim mortar i vitit 1608 në kishën ortodokse të Shën Pjetrit e Palit në Napoli, i cili bën fjalë për dy komandantë të një trupe stratiotësh shqiptarë prej 300 vetësh.<sup>84</sup> Pikërisht, në fillim të shek. XVII konstatohet një fushatë e ethshme rekrutimesh të napoletanëve në gjithë shtrirjen bregdetare, nga Dhërmiu në Pargë (*da Drimades fino alla Parga*)<sup>85</sup>. Kjo, padyshim, lidhej me rolin aktiv që morën atë kohë spanjollët në luftën me Perandorinë Osmane. Në planet e tyre të luftës, shqiptarët zinin një vend

<sup>81</sup> “*si esperiente per simil negotio poiche li conveniva per simil negotio non solo à saper la lingua grecha, et albanesa come lo sa, ma anche scriverle*”, P. Bartl, *Der Westbalkan zwischen spanischer Monarchie...*, f. 148.

<sup>82</sup> “*nell’epoca del principe Scanderbeg, quando passarono con le navi nei territori di quel regno per andar a Barletta e liberar il Re Ferrante dall’assedio dei suoi nemici francesi*”, .

<sup>83</sup> J. M. Floristan, “Jeronimo Combis, capitan de estradiotes ...”, f. 186.

<sup>84</sup> “*Qui riposano i due fratelli Capitani di una Compagnia ordinaria in questo regno, di trecento soldati a cavallo, nominati Sdradiotti, concessa dalla Real Corona di Spagna alla casa dei detti nobili Capitani Albanesi nell’anno 1608*”, shih: *Dissertazione istorico-cronologica del Regimento Real Macedone*, in Bologna: presso il Volpe, 1767, f. 46-47; Attanasio Leh, *Cenno storico dei servigi militari prestati nel regno delle due Sicilie dai greci epiroti albanesi e macedoni in epoche diverse*, Corfù: 1843, f. 7.

<sup>85</sup> ASV, *Dispacci Corfù*, b. 10 (1615-1616): Raport nga Korfuzi i proveditorit Vincenzo Grimani, 5 prill 1616.

të dorës së parë<sup>86</sup>. Bazuar edhe në përvojën veneciane, spanjollët e Napolit nuk mund të mos vlerësonin në ato momente përplasjeje me osmanët, rolin e stratiotëve, të këtyre luftëtarëve të hipur mbi kalë (*soldati à cavallo*),<sup>87</sup> që dikur, më 1498, kishin mahnitur edhe kronistin francez Philippe de Commines i cili i kishte parë në aksion<sup>88</sup>.

### **Nga emigrimi i stratiotëve tek emigrimi i bashkësive**

Në vitin 1531, banorët shqiptarë të fshatrave rreth kështjellës së Koronës, në Man të Moresë, ngritën krye dhe, pasi dëbuan prej andej garnizonin osman, shpallën se i vinin kështjellën e territorin rreth saj nën sovranitetin e perandorit të Spanjës, Karli V. Por, siç mësohet nga një Memorial i vitit 1619 i Jeronim Kombit, pas dy vjetësh, perandori vendosi t'ia lëshojë turqve Koronën në këmbim të kështjellës së Varadinos (Nagyvarad), në Hungari, që turqit ua kishin shkëputur trupave perandorake pak kohë më parë<sup>89</sup>. Lajmin e konfirmon edhe një citim, që M. Mandalà e ka shkëputur nga autori sicilian i shek. XVI, Tommaso Fazello<sup>90</sup>. Kështu, pas lëshimit të kështjellës, më 1533, mbrojtësit shqiptarë të Koronës hipën në bordin e anijeve të Andrea Dorias, dërguar nga Mëkëmbësi i Napolit, Pedro di Toledo, dhe iu drejtuan brigjeve të Italisë<sup>91</sup>.

<sup>86</sup> P. Bartl, *Der Westbalkan zwischen spanischer Monarchie ...*, passim.

<sup>87</sup> ASV, *Dispacci Corfù*, b. 19 (viti 1635-6): raport i proveditor-kapitenit Pietro Loredano, Korfuz, 2 shkurt 1638.

<sup>88</sup> Ph. Commines, *Memorie*, Torino, 1960, f. 477 e vijim.

<sup>89</sup> “y los griegos en este mismo tiempo en la ciudad de Coron, de donde sacaron los Turcos y entregaron la dicha ciudad y dieron vasallaje al dicho emperador, y de allí a dos años habiendo capitulado la dicha Magestad Cessarea devolver la dicha ciudad de Coron a los Turcos para que ellos volviessen la de Varadino que avian ocupado in Ungria, eligieron los nobles, y con ellos muchos vezinos, más presto privarse de sus propios vienes y hacienda que quedar debaxo del dominio tiranico, por lo que se embarcaron en la armada de vuestra Magestad y vinieron a residir en el dicho reyno de Nápoles”, José Floristán, “Jerónimo Combis, capitán de estradiotes y superintendente general del servicio español de espionaje en Nápoles”, *Erytheia* 36, Madrid: 2015, f. 189.

<sup>90</sup> Matteo Mandalà, *Mundus vult decipi. I miti della storiografia arbëreshe*, Palermo: Mirror, 2007, f. 168.

<sup>91</sup> P. P. Rodotà, *Dell'origine, progresso e stato presente ...*, vol. III, f. 54-58; Michelangelo Mendella, “Arruolamenti militari albanesi nel Regno di Napoli durante il Seicento”, në *Archivio Storico delle Province Napoletane*, XC, Napoli: 1973, f. 375.

Për këtë valë migratore nga Mani drejt territoreve të Mbretërisë së Napolit flet edhe autori arbëresh i shek. XVIII, Pietro P. Rodotà<sup>92</sup>. Sipas tij, në vitin 1532, shqiptarët e ardhur kohë më parë nga Shqipëria e të vendosur në krahinën e Koronit, në More, ngritën krye kundër pushtesve osmanë dhe me ndihmën e trupave spanjollë të ardhura aty në ndihmë të tyre, të kryesuar nga admirali i flotës Andrea Doria, mundën t'u shkëpusin turqve kështjellën e Koronit e gjithë fshatrat përreth saj. Por, nuk kaloi shumë, dhe forca të shumta osmane erdhën aty dhe pas luftimeve të ashpra, spanjollët vendosën ta braktisin kështjellën. Një flotë e madhe prej 200 anijesh shpëtoi nga hakmarrja e Sulltanit kryengritësit shqiptarë e familjet e tyre dhe i solli ato në brigjet italiane. Grupe të tyre u sistemuan në Barile, dioqezë e Melfit, në San Demetrio (Shën Mitër) në dioqezën e Rossanos, e në San Benedetto Ullano, dioqezë e Bisignanos<sup>93</sup>. Rodotà shënon, gjithashtu, si lokalitet ku u sistemuan refugjatët nga Korona edhe fshatin Maschito, në Basilicata<sup>94</sup>. Pikërisht, të dhënat e Rodotà për sa i përket ardhjes së refugjatëve nga Korona e Manit (Peloponez) dhe sistemimit të tyre në lokalitetin Maschito, gjejnë mbështetje edhe në dokumente të Arkivit të Napolit, përkatësisht në librin e llogarive të Mbretërisë së Napolit (Regie Camere Summarie). Në regjistrimet që i përkasin vitit 1583, flitet për një Mërkur Maneshi dhe vëllain e tij Andrea Maneshi, i cili në regjistër shënohet si “grek koronë i lindur në këtë Mbretëri, djalë i një refugjati nga Korona” (*Andrea Manes greco Coroneo nato in Regno da padre venuto da Coron*)<sup>95</sup>. Bashkë me të regjistrohet aty edhe një Dhimitër Xhamata për të cilin, gjithashtu, thuhet se ishte “grek koronë i lindur në këtë Mbretëri”, d.m.th. në Mbretërinë e Napolit (*Demitre Giamatta greco Coroneo nato in questo Regno*)<sup>96</sup>. Por, në të njëjtin dokument, prezantimi i Dhimitrit shtjellohet më tej, duke u shtrirë tek të dhënat për të atin e tij, Aleksin. Ky, ndryshe nga i biri, prezantohet si “Shqiptar koronë” (*Albanese Coroneo*): “Aleksi në fjalë ishte nga një fshat, i quajtur Kodon, që ndodhej dhjetë milje larg kështjellës së Koronës, dhe në kohën e rrethimit të saj nga turqit u fut brenda mureve, dhe luftoi derisa si shumë koronej të tjerë u detyrua të

<sup>92</sup> P. P. Rodotà, *Dell'origine, progresso e stato presente ...*, vol. III, f. 54-58.

<sup>93</sup> *Po aty*, f. 54-55.

<sup>94</sup> *Po aty*, f. 56.

<sup>95</sup> S. Lambros, “Metanasteusis Ellenon idios Peloponnesion apoikon eis to Basileion ...”, f. 444.

<sup>96</sup> *Po aty*, f. 441.

largohej dhe, hipur mbi anije, zbarkoi në territorin e Mbretërisë së Napolit, në Otranto, prej nga kaloi në Moschito, ku u sistemua dhe u bë me grua e dy djem, Dhimitrin e Karlin<sup>97</sup>. Mënyra si regjistrohet përfaqësuesi i brezit të parë të banorëve të Maschito-s, Aleks Xhamata (*Albanese Coroneo*) tregon qartë se në rastin e Maschito-s kemi të bëjmë me një koloni shqiptarësh të ardhur nga Korona e Manit (Peloponez) në vitin 1533. Atributi “grek” me të cilin shfaqet djali i tij, Dhimitër Xhamata në regjistrin e vitit 1583, qartësisht i referohet ritit bizantin (“grek”) që ai dhe të ardhurit e tjerë shqiptarë nga Korona e Manit aplikonin. Siç u tha më sipër, në të njëjtin regjistër, në aktet e vitit 1583, shënohet edhe vërtetimi i lëshuar në favor të dy vëllezërve, bij refugjatësh nga Korona, që i përkisnin familjes fisnike shqiptare të Maneshëve, Andrea e Mërkur Maneshi. Këta, njëlloj si Dhimitër Xhamata, identifikohen në regjistër sipas ritit fetar: “Mërkuri, vëlla i Andrea Maneshit, grek koroné, lindur në Mbretërinë e Napolit nga një baba i ardhur nga Korona<sup>98</sup>. Dihet se Maneshët ishin një ndër familjet më të shquara nga Shqipëria e Mesme. Një Pal Maneshi kishte qenë komandant i kalorësisë, një ndër gjeneralët më besnikë të Gjergj Kastriot Skënderbeut në betejat e tij me osmanët<sup>99</sup>. Edhe pas pushtimit të Shqipërisë nga këta të fundit, aty nga viti 1608, një Idar Maneshi, pinjoll i islamizuar i asaj familjeje, mbante ndezur frymën e kryengritjes antiosmane në viset e Matit e të Mirditës<sup>100</sup>. Nuk ka dyshim, se Mërkur e

<sup>97</sup> “*il detto Alesio padre di esso Diomitre era Albanese Coroneo de uno suo casale detto li Chodoni distante da detta città circa dece miglia, et che al tempo dell' Assedio se ritirò dentro di essa, et che abandonata detta città se ne venne in questo regno sopra uno vascello in Otranto, et dopo passò in Maschito, dove se accasò et fè doi figli nomine Diomitre et Carlo*”, po aty, f. 441-442.

<sup>98</sup> “*si è comparso in questa Regia Camera per parte di Mercurio fratro di Andrea Manes greco Coroneo nato in Regno da padre venuto da Coron*”, po aty, f. 444.

<sup>99</sup> “*Paulus Manessi notus equestri gloria bellator*”, Marinus Barletius, *Historia de Vita et Gestis Scanderbegi, Epirotarum Principis*, Roma: Bernardinus de Vitalibus, s. a., f. 42.

<sup>100</sup> “*come dunque il fù detto potriano i Albanesi impatronirsi di quello luogo di sito forte et con tanto pressidio, risposero tutti duoi un dopo l'altro che si faria con intelligentia di figlioli di Albanesi fatti Turchi nominando per principale uno Ider Manessi Turco figliolo di Albanese, il qual Ider che è fratel giurato di quel vescovo Steffanense si faria Christiano et è potente di dipendentie et faria lui solo più di 500 cavalli*”, dokumenti në: Gligor Stanojević, “Dokumenti o zavjeri Albanskih prvaka iz 1602 godine”, në *Balkanica* 3, Belgrade: 1972, f. 313.

Andrea Maneshi, bijtë e një refugjati të ardhur në Maschito nga Morea, i kishin rrënjët e të parëve pikërisht në Shqipërinë e Mesme.

Një dëshmi më e hershme e lëshuar nga një tjetër banor i Maschitos, Gjon Madhi (*Giovani Mathes*), bën të ditur se Aleks Xhamata kishte qenë ushtar i tij gjatë rrethimit të Koronës, dhe të dy, bashkë me shumë shqiptarë të tjerë, ishin larguar prej andej për t'u vendosur në Maschito të Bazilikatës<sup>101</sup>. Për këtë familje flitet edhe në një memorial të vitit 1588, shkruar nga Angelo Madhi, ku thuhet se gjyshi i Angelos, *Lazzaro Mates*, ishte larguar nga Shqipëria në fund të shek. XV dhe kishte hyrë në shërbim të Ferdinandit të Napolit si kapiten i kalorësisë. Në vitin 1507, në këmbim të shërbimeve të tij, Mbreti Ferdinand i kishte dhuruar Lazarit fshatin Maschito, afër Potenza-s (Basilicata), të cilin perandori Karli V ia konfirmoi me dekret të veçantë më 1519<sup>102</sup>. Rezulton, kështu, se vendosja e refugjatëve nga Korona e Manit në fshatin Maschito të Bazilikatës, më 1533, nuk ishte e rastësishme. Fshatin në fjalë e kishte “zbuluar” qysh më 1507 Llazar Madhi, i ardhur nga Shqipëria, përpara se aty të mbërrinte nga Korona një tjetër Madhi, kapiteni Gjon Madhi. Ky, bashkë me “shqiptarin koronë” Aleks Xhamatën e të tjerë mbrojtës të kështjellës së Koronës, në vitin 1533 u vendosën bashkë me familjet në fshatin Maschito, i cili prej vitit 1507 ishte feud i Llazar Madhit nga Shqipëria. Kolonizimi shqiptar i Maschitos na jep një rast interesant të tipologjisë së emigracionit shqiptar në Italinë e Jugut, ku në të njëjtin fshat, sedimentohen prurje të ndryshme refugjatësh shqiptarë, që vinin në kohë të ndryshme, por edhe nga vende të ndryshme. Fakti që fshati Maschito ishte themeluar nga një pjesëtar i fisit Madhi i ardhur nga Shqipëria, nuk është pa rëndësi për të shpjeguar mbërritjen aty, vite më vonë dhe nga një tjetër zonë shumë larg Shqipërisë, nga Mani i Moresë, të një tjetri pjesëtar të këtij fisi, kapitenit Gjon Madhi, pas çdo gjase farefis i të parit. Kjo tregon se përkatësia dhe lidhjet familjare përbënin një fill të rëndësishëm që përcaktonte drejtimin e emigracionit shqiptar në mesjetë, ashtu si edhe në ditët e sotme.

Historia e shqiptarit nga Korona e Manit, Aleks Xhamata dhe e kapitenit të tij, Gjon Madhi, ishte histori e shumë banorëve të tjerë të

<sup>101</sup> “*ha mostrato patente del quondam Magnifico Giovan Matthes, per la quale appare Alexio Giamatta essere suo soldato*”, po aty.

<sup>102</sup> José M. Floristán, “Societad, economia y religion en las comunidades griega y albanesa de Napoles y Sicilia: nuevos documentos ineditos”, në *Erytheia* 37, Madrid: 2016, f. 132, 133.

Maschito-s, bashkëkombës, bashkëlufëtarë e bashkëvuajtës të tij, për të cilët perandori i Spanjës e i Napolit, Karli V, më 13 korrik 1534, shpalli një listë me privilegje e të drejta<sup>103</sup>. Nga fondi i arkivit napolitan “Comune Sommarie” mësohet gjithashtu se në korrik 1534 perandori Karli V shpalli privilegjet edhe për refugjatët e ardhur nga Korona dhe të vendosur në Lipari (Sicili). Koronejtë e atyshëm (*Coronenses*) fitonin me atë rast po ato të drejta e imunitete, që gëzonin prej vitit 1502 edhe vetë banorët e Liparit<sup>104</sup>. Në vitin 1562, këto privilegje iu rikonfirmuan koronejve të Liparit, sipas kërkesës që kishte paraqitur Nikolla Bartini, një fisnik koronë (*nobile Coronese*)<sup>105</sup>. Në regjistrat në fjalë flitet gjithashtu për koronej të vendosur në Mesagne e në Masafra (Pulje)<sup>106</sup>. Të gjitha këto fakte, na shtyjnë t’i shohim me dyshim pohimet e Paolo Petta e Matteo Mandala, të cilët piren ta ridimensionojnë problemin e koronejve në Italinë e Jugut, makar edhe duke i konsideruar ata kryesisht me origjinë greke o latine<sup>107</sup>. Që vetë koronejtë e Manit pretendonin të gëzonin një status të veçantë, këtë e provon edhe episodi i mëposhtëm. Në vitin 1570 banorët e Manit, me kryeqendër Koronin, kishin ngritur krye kundër Portës dhe arritën të pushtojnë e të rrënojnë një fortesë të kontrolluar nga turqit. Pas kësaj, një delegacion i Maniotëve u paraqit përpara Senatit në Venedik, duke premtuar se shumë shpejt do të çlironin gjithë Morenë, të cilën do t’ia dorëzonin Republikës. Si shpërblim, më 4 maj 1571, Senati vendosi të kënaqë kërkesën e tyre, i pranoi si shtetas venecianë banorët e Manit dhe u njohu titullin e trashëgueshëm të “fisnikut të Moresë” gjithë krerëve të asaj krahine, “duke u akorduar atyre nderet, avantazhet, përfitimet dhe çdo benefic tjetër që gëzonin edhe

<sup>103</sup> “*di privilegi franchezze, concesse per la felice memoria della Cesarea Maiestà di Carlo V all’università homeni et particolari persone della città di Coro ordinati per lo quondam Illustrissimo Don Pietro di Toledo olim Vecerè locotenente et Capitano Generale in questo Regno osservansi alli Greci Coronei venuti dopo l’impresa de’Turchi in questo predetto regno mediante suo opportuno privilegio ad beneplacitum Cesarearum et catholicarum Majestatum sotto la data nel Castello novo di questa città di Napoli a 13 Luglio 1534*”, S. Lambros, “Metanasteusis Ellenon idios Peloponnesion apoikon ...”, f. 444.

<sup>104</sup> S. Lambros, “Metanasteusis Ellenon idios Peloponnesion apoikon ...”, f. 413-414.

<sup>105</sup> Po aty, f. 415.

<sup>106</sup> Po aty, f. 420, 456.

<sup>107</sup> Paolo Petta, “L’esodo dei Coronei. Una pagina della storia degli Italo-Albanesi”, në *Incontri Meridionali, rivista quadrimestrale di storia e cultura* 1/3, Cosenza: L. Pellegrini, 1996, f. 53; Matteo Mandalà, *Mundus vult decipi. I miti della storiografia arbëreshe*, Palermo: Mirror, s. a., f. 164, 180.

fisnikët e tjerë të asaj province dhe duke i çliruar ata nga çdo detyrim e angari tjetër”<sup>108</sup>.

Por nuk është kjo prova e vetme, që tregon se elita drejtuese e bashkësisë së koronejve gëzonte traditën e një trajtimi të veçantë nga vendet aleate. Në fakt, më sipër cekëm rastin e Nikolla Bartinit, koroné i Liparit, që regjistrohet si “fisnik koroné” (*nobile Coroneo*)<sup>109</sup>. Por mjaftojnë edhe emrat familjarë të disa koronejve, sa në More, a edhe në ishujt jonianë, në Itali e Dalmaci, për të gjykuar për statusin social, më së paku, të një grupi konsistent të shqiptarëve të Koronit. Përveç emrave Maneshi, Madhi, Bartini, Kunani që u cituan më sipër, kemi edhe një Gjergj Niksha nga Korona, të sistemuar në Mesagne (*Giorgio Nichiscia*)<sup>110</sup>. Më 1569 përmendet një *Bardi Dara da Coron*, stratiot, i cili shërbente në kompaninë e Agostino Barbatit, me detyrë në Trogir të Dalmacisë<sup>111</sup>. Mund të hamendësojmë se kapiteni Agostin Barbati ishte edhe ai, si Bardhi Dara, nga Koroni. Gjithsesi, me siguri ishte nga Koroni një tjetër pinjoll i familjes Barbati bashkëkohës i tij, Luca Barbati (*Luca Barbato Coroneo*) i cili atë kohë banonte në Masafra<sup>112</sup>. Familjet Barbati e Dara njihen si themeluese vendbanimesh shqiptare, përkatësisht të Piana degli Albanesi e të Palazzo Adriano-s, në Sicili<sup>113</sup>. Ndërkohë, në Koronë e Man kishin mbetur jo pak pasardhës familjesh me emër, siç na jep të kuptojmë rasti i përmendur i krerëve të Manit, mes të cilëve edhe Kalopet Fuga, që në vitin 1571 morën nga Senati i Venedikut titullin e “fisnikut të Moresë”. Emrin e një fisi të shquar shqiptar nga Arbëria e

<sup>108</sup> “*che li detti fidelissimi nostri di Mayna siano accettati per nostri carissimi sudditi et figliuoli, et occorrer che per gratia della divina maestà favoriti dalla bona intentione col molto suo valore, s’impatronissero per nome nostro della Morea, et cosi deliberamo col Senato che li primarii della predetta Mayna et li loro heredi et dessendenti in perpetuo, siano nobeli d’essa Morea, et godino tutti li honori, preheminentie, utili et ogni altro beneficio c’hanno li altri nobili d’essa provintia, senza obligo di pagar gravezza di sorte alcuna et oltra ciò*”, ASV, Sen. Mar, filza 48 (mars-gusht 1571): 4 maj 1571, in Rogatis. Por, më 14 maj, anëtarët e dërgatës së Manit që vazhdonin të ishin në Venedik, ku bënte pjesë edhe një Kalopet Fuga (*Calopeto Fuccha*), i paraqiti Senatit kërkesën që të gjithë banorët e Manit, dhe jo vetëm krerët, të përjashtoheshin nga detyrimet e angaritë për shtetin e Venedikut. *Po aty*.

<sup>109</sup> S. Lambros, “Metanasteusis Ellenon idios Peloponnesion apoikon ...”, f. 415.

<sup>110</sup> *Po aty*, f. 420.

<sup>111</sup> ASV, Sen. Mar, filza 42 (gusht-tetor 1569).

<sup>112</sup> S. Lambros, “Metanasteusis Ellenon idios Peloponnesion apoikon ...”, f. 456.

<sup>113</sup> V. Dorsa, *Su gli Albanesi. Ricerche e pensieri ...*, f. 74.

Poshtme mbante, më 1570, edhe tregtari koronë Lekë Malakasi (*Lecca Malacassa da Coron*)<sup>114</sup>.

Një burim dokumentar, i botuar nga S. Lambros, dhe ndonjë autor i hershëm, si Pietro Pompilio Rodotà në vitin 1758, flasin edhe për një valë migratore disi të vonë (1670), që erdhi përsëri nga Mani i Moresë e nuk përfundoi në territoret e Mbretërisë së Napolit, por në ato të Dukatit të Madh të Toskanës. Shkaku i saj ishte, siç kuptohet, përfshirja e banorëve të krahinës luftarake të Manit në ngjarjet luftarake të zhvilluara gjatë Luftës së Kandias (1645-1669). Me atë rast, burrat e Manit rrokën armët kundër turqve osmanë duke u rreshtuar në krah të Republikës së Venedikut. Por, siç kishte ndodhur edhe më parë<sup>115</sup>, me mbarimin e luftës, maniotët u braktisën nga venecianët. Nuk u përfshinë prej tyre në traktatin e paqes dhe u gjendën të vetëm përballë hakmarrjes së Sulltanit. Për rrjedhojë, më 6 tetor 1663, një përfaqësi e tyre iu drejtua me një letër Dukës së Madh të Toskanës, duke deklaruar se maniotët dëshironin të emigronin në territoret e tij, “për t’i shpëtuar hakmarrjes së armiqve” (*per sottrarsi dalla fierezza dei loro nemici*)<sup>116</sup>. Bëhej fjalë për 300 familje, gjithsej 1500 vetë, të cilët në Toskanë do duhej të pajiseshin me parcela toke për të siguruar jetesën. Refugjatët do merrnin me vete farërat si dhe ushqime, për të mbajtur veten deri në korrjet e para. Do të sillnin në Toskanë edhe priftërinjtë e tyre “grekë”, të cilët do t’i mbanin ata vetë, me shpenzimet e tyre (*che il sacerdote o sacerdoti greci che dovranno assistere alle cose divine, saranno da essi supplicanti pagati et satisfatti*

<sup>114</sup> ASV, *Senato Mar*, filza 46: në Pregadi, 25 shtator 1570.

<sup>115</sup> Braktisjen veneciane e denoncon Gjon Muzaka në “Kronikën” e tij: “*ma il detto Turco fando poi pace con Venetiani, quando li donaro Scutari, non me volsero comprendere in quella, anzi promisero in lor mano venisse*”, Giovanni Musachi, “Breve memoria de li discendenti de la nostra casa”, në Charles Hopf, *Chroniques gréco-romanes inédites ou peu connues*, Berlin: Librairie de Weidmann, 1973, f. 276. Po ashtu, siç tregon një letër e ipeshkvit të Kurcolës e vitit 1595, pas kryengritjeve të himariotëve të viteve 1570, të inkurajuara nga vetë Republika e Venedikut, kjo i braktisi himariotët në fjalë “në kulmin e tyre” dhe lidhi përsëri paqe me Portën (*tanto più che fino l’anno 70 haveanno trattato insieme fino alla Cimara la sollevatione, et quando li Venetiani non li havessero tradito nel più bello*), P. Bartl, *Der Westbalkan zwischen spanischer Monarchie ...*, f. 218.

<sup>116</sup> S. Lambros, “O katà ton dekaton ebdomon aiona eis ten Toskanan eksoikismos ton Maniaton”, në *Neos Ellenomnemon 2*, Athene: 1905, f. 399, 402.

*del proprio*)<sup>117</sup>. Shpenzimet e udhëtimit, 4 dukate për ata që udhëtonin pa bagazh, e 8 real për ata që do bartnin edhe bagëti e ushqime, duhet të hiqeshin fillimisht nga Duka, të cilin do t'i shlyheshin më vonë nga të interesuarit, në natyrë ose në të holla. Maniotët merrnin përsipër të shlyenin të gjitha detyrimet feudale, si çdo bujk tjetër. Premtonin gjithashtu, se do i përdornin armët vetëm në favor të Dukës, dhe kur këtë do ua kërkonte Duka. Në fund, luteshin që t'u vihej në dispozicion ndonjë mjet lundrues, me të cilin të mund të ushtronin piraterinë, duke premtuar se do i jepnin Dukës pjesën e plaçkës që i takonte (*di poter navigare et andare in corso liberamente da per loro..., con riconoscere però Vostra Amatissima Signoria delle prede che ne faranno*)<sup>118</sup>. Mes 15 firmëtarëve të letrës, pesë i përkisnin familjes Stefani (Stefanopulli)<sup>119</sup>.

Në maj të vitit 1670, kur Lufta e Kandias kishte përfunduar tashmë dhe gjendja e banorëve të Manit ishte bërë e padurueshme<sup>120</sup>, duka i ri i Toskanës, Cosimo III di Medici, dërgoi me mision në Man dy kapitenë, Gjergj Mikelin dhe Nikolla Arvanitin (Niccolò Arvanitti). Mbiemri i të dytit flet qartësisht për origjinën shqiptare të tij. Pra, dy emisarët e Dukës, të cilët me siguri kishin familjaritet me vendin dhe me banorët e Manit, takuan krerët e tyre, me të cilët nënshkruan pikat e marrëveshjes, që do rregullonte transferimin e maniotëve në Toskanë dhe sistemimin e tyre atje<sup>121</sup>. Teksti i marrëveshjes i përmbahet, *grosso modo*, kërkesave të paraqitura më parë nga maniotët. Ndaj këtu po cekim vetëm kapitullin që flet për besimin fetar, i cili përcaktonte se refugjatët nga Mani në Toskanë “duhet të jetonin sipas ritit të kishës greke të bashkuar me atë katolike, në formën që praktikohet në qytetin e Livornos” (*vivere secondo il rito della Chiesa Greca unita alla Latina nella forma che si pratica in*

<sup>117</sup> Në një tjetër letër të tyre, të pa datuar, që me sa duket “korrekton” të parën, maniotët insistojnë tek e drejta për të ushtruar ritin greko-bizantin të tyre dhe për të pasur një peshkop, njëloj siç ishte vepruar në Venedik me komunitetin ortodoks të atij qyteti. Kësaj radhe kërkohej, gjithashtu, që maniotët të përjashtoheshin për 15 vjet nga detyrimi i së dhjetës dhe nga çdo detyrim tjetër. S. Lambros, “O katà ton dekaton ebdomon aiona ...”, f. 405.

<sup>118</sup> Po aty.

<sup>119</sup> S. Lambros, “O katà ton dekaton ebdomon aiona ...”, f. 403, 404.

<sup>120</sup> Robert Mantran, *Historia e Perandorisë Osmane*, Tiranë: Dituria, 2004, f. 233, 235. Pas marrjes së Kretës, Veziri i Madh, që atë kohë ishte shqiptari Fazil Ahmet Pashë Qyprilliu, kishte dërguar ushtri për të nënshtruar përfundimisht shqiptarët e Manit dhe për të ndërtuar fortesa të reja në breg të detit.

<sup>121</sup> S. Lambros, “O katà ton dekaton ebdomon aiona ...”, f. 423, 424.

*Livorno*)<sup>122</sup>. Tani, Pietro Rodotà na bën të ditur se në vitin 1572 dhe më vonë në vitin 1593 përkatësisht dukët e Toskanës, Cosimo I dhe Francesco I, u dhuruan “grekëve” të vendosur në Livorno kishën e Shën Jakobit të Acquaviva-s. Më vonë, më 1628, “grekët” në fjalë ngritën me shpenzimet e tyre kishën Shën Mëria e Grekëve, siç e dëshmon edhe mbishkrimi i kopjuar e i botuar nga Montfaucon në ditarin nga udhëtimi i tij në Itali<sup>123</sup>. Duke iu kthyer përsëri tekstit të marrëveshjes së vitit 1670 të krerëve të Manit me të dërguarit e Dukës së Toskanës, bën përshtypje fakti, që marrëveshja në fjalë kësaj radhe nuk përmban firmën e anëtarëve të familjes Stefanopulli, të cilët kishin luajtur rolin kryesor në vendosjen e kontakteve të para me Dukën e Madh të Toskanës. Ka shumë të ngjarë, që Stefanopullët të ishin shpërngulur më herët në Toskanë, ndoshta menjëherë pas letrës së parë që iu dërgua Dukës, më 1663, gjithsesi përpara vitit 1670, kur dërgata e Dukës arriti marrëveshjen me krerët e Manit. Në fakt, në shek. XVIII e XIX ata dëshmohen vazhdimisht në Itali, madje si përfaqësues të komunitetit të maniotëve të ardhur nga Morea. Duke u nisur nga precedentë të ngjashëm<sup>124</sup>, mendojmë se

<sup>122</sup> Në Livorno ishte ngritur që në vitin 1628 kisha e Shën Mërisë së Grekëve, e cila frekuentohej nga komuniteti i madh i emigrantëve të besimit ortodoks që ishin strehuar me privilegj të veçantë të Dukës Cosimo I duke filluar nga viti 1572. Shih: P. P. Rodotà *Dell'origine, progresso e stato del rito greco in Italia ...*, vol. III, f. 229.

<sup>123</sup> *Po aty*, f. 229.

<sup>124</sup> Përshkruajmë shkurtimisht këtu historinë e dëshmuar në një akt noterial të vitit 1655 nga Arkivi i Lecce-s, ku në cilësinë e deklaruesit shfaqen Antonio Mazzareca (Mazreku) nga fshati Mazrek “në provincën e Epirit” dhe Dhimo Maneshi (*Dima Manesi*) nga fshati fqinj Smokovinë, në zonën e Margëlliçit, Arbëri e Poshtme. Sipas rrëfimit të tyre, banorët e Luaratit, që deklaruesit e cilësojnë si qytet (*città di Luvaratta*), pas ndërtimit të kështjellës së Margëlliçit nga ana e turqve, më 1571, u gjendën nën presionet e persekutimit e vazhdueshme të tyre. Më në fund, turqit i konvertuan banorët e Luaratit në fenë e tyre “të mallkuar” (*e ridusse per odio suo antico alla sua maledetta setta*). Megjithatë, një grup banorësh të Luaratit (noteri i quan ata “*Livarotti*”) rindërtuan një kishë të vjetër, dy milje larg Luaratit, të cilën ia dedikuan Shën e Premtes (Santa Veneranda). Por edhe aty turqit nuk i lanë të qetë, dhe rreth 35 vjet përpara se të hartohej ai dokument, pra në vitin 1625, ky komunitet i vogël të krishterësh nga Luarati mori rrugët dhe zbarkoi në Lecce të Italisë, pikërisht aty ku shumë dekada më parë ishte vendosur Gjon Livarotti, një bashkëfshatar i tyre. Kishte qenë pikërisht ky, që dy vjet pasi banorët ishin larguar nga Luarati dhe ishin vendosur në vendin ku ngrihej kisha e vjetër e Shën e Premtes, u kthye në vendlindje për të shpëtuar nga zgjedha osmane e për t’i zhvendosur në Itali bashkëfshatarët e vet. Deklaruesit precizojnë se Gjoni veprroi në këtë mënyrë, “pasi ashtu e kërkonte zakoni i vjetër i vendit” (*due anni dopo la loro fuga da Luvarotta, il suddetto Giovanni tornò*

Stefanopullët u shpërngulën të parët në Toskanë, dhe prej aty nxitën fillimisht dërgimin në Mani të dy ambasadorëve të Dukës me tekstin e marrëveshjes, ku ata me siguri kishin vënë dorë, dhe më tej organizuan tërheqjen e bashkëpatriotëve të tyre në Dukatin e Madh të Toskanës.

Në fakt, Stefanopullët ndeshen pas një shekulli në lokalitetin Cargese (Ajaccio) në Korsikë, ku atë kohë bënin pjesë në parinë e vendit<sup>125</sup>. Njëri prej tyre botoi në Paris, më 1826, librin “Histori e kolonisë greke të Korsikës” (*Histoire de la colonie Grecque établie en Corse*), ku tregon se Stefanopullët ishin me origjinë nga Mani i Peloponezit. Prej aty, në vitin 1675, ishin hedhur në Dukatin e Madh të Toskanës dhe pas një farë kohe, ishin stabilizuar përfundimisht në Cargése (Paomia-Korsikë)<sup>126</sup>. Një tjetër pinjoll i shquar i familjes Stefanopulli, Nikolla, i cili shërbeu në ambasadën e Francës pranë Portës së Lartë e më tej arriti të bëhej dhe anëtar i Senatit francez, shkruajti edhe ai një libër, “Shpirti i kolonive greke, spartane dhe populli autokton i Korsikës” (*Génie des colonies grecques, spartiates et peuple indigène de la Corse*, Paris, 1843), ku pohon, mes të tjerash, se vendlindja e tij, Cargése, ishte njëherësh edhe vendlindja e Napoleon Bonapartit, të parët e të cilit, ashtu si Stefanopullët, kishin mbërritur aty në shek. XVII nga Toskana<sup>127</sup>. Stefanopullët kishin lidhje miqësore me Bonapartin, i cili u drejtohej atyre me fjalët “bashkëqytetarë e bashkëpatriotë të mij”<sup>128</sup>. Në vitin 1797,

*al suo paese per salvar gente conforme al suo antico costume*)<sup>124</sup>. Me siguri, me atë rast ai mori me vete një numër bashkëfshatarësh, përpara se i gjithë komuniteti i Luaratasve të krishterë të shpërngulej përfundimisht në Itali. Siç mund të konstatohet lehtë, historia e zbrazjes së fshatit Luarat me faza dhe drejt viseve tashmë të eksploruara, kujton një skemë emigrimi familjar e komunitar, që është përsëritur *tale-quale* edhe në historitë e reja të emigracionit shqiptar. Shih: Salvatore Panareo, “Albanesi nel Salento e Albanesi al servizio del Regno di Napoli”, në *Rinascenza Salentina* viti VII, nr. 4, Lecce: 1939, f. 9-10.

<sup>125</sup> George Finley, *Istoria tes tourkokratias kai tes Venetokratias sten Ellada*, Athinë: 1972, f. 157; Nicolaos Stephanopoli, *Histoire de la colonie grecque établie en Corse*, Paris: A. Thoisionier-Desplaces, 1826, f. 19.

<sup>126</sup> P. Stephanopoli, *Histoire de la colonie Grecque ...*, Paris: 1826; G. G. Papadopoulou, *Chronographia perì tes katagoges ton en te Mane Stephanopoulon*, Athinë: 1865; S. Lambros, “O katà ton dekadon ebdomon aiona ...”, f. 396.

<sup>127</sup> Nicolaos Stephanopoli de Comnène, ancien attaché à l’ambassade de France près la Porte Ottomane, *Génie des colonies grecques, spartiates et peuple indigène de la Corse*, Paris: L. Mathias, libraire-éditeur, 1843, f. XXXVII.

<sup>128</sup> Dimo Stephanopoli, *Voyage en Grèce pendant les années 1797-1798*, vol. I, Paris: 1800, f. 30.

porsa shtiu në dorë ishujt e Jonit, Napoleon Bonaparti dërgoi prej aty me një mision zbulimi në Mani dy vëllezër, Dhimo e Nikolla Stefanopulli. Dhimo e rrëfen përvojën e vet në atdheun e të parëve në librin “Udhëtim në Greqi në vitet 1797-1798” (*Voyage en Grèce pendant les années 1797-1798*, vëll. I, Paris, 1800). Sipas rrëfimit të tij, detajet e misionit në Mani ia shpjegoi Dhimos vetë Napoleon Bonaparti, në prani të gjeneralit Beauharnais, i cili, në një moment të caktuar e pyeti Stefanopullin: “A mos jeni korsikan” (*Etes-vous corse*)? Dhimo nuk arriti të hapë gojë, sepse në vend të tij u përgjigj në çast vetë Napoleon Bonaparti: “Është shumë më tepër se korsikan: është spartan”. Napoleoni i besoi Dhimo Stefanopullit dy letra: njerën për krerët e Manit dhe një tjetër, që ishte letër-rekomandimi e shkruar në greqisht, i drejtohej Beut të Manit, i cili ishte një maniot i konvertuar. Në fakt, letra e rekomandimit e Napoleonit për të fillonte me fjalët: “Ju rekomandoj prurësit e kësaj letre, të cilët janë, ashtu si edhe Ju, pasardhës të Spartanëve”. Dhimo rrëfen, se në momentin e takimit i ishte drejtuar Beut me fjalët: “Unë dhe im vëlla, përsa kohë jemi korsikanë, ndjehemi francezë të adoptuar; por jemi edhe grekë, madje jo vetëm grekë, por edhe maniotë. Ju do e kenë vënë re këtë nga mënyra se si e flasim gjuhën Tuaj”. Në fakt, vazhdon rrëfimin e tij Dhimo Stefanopulli, Beu u përfshi nga një admirim i papërshekruar duke dëgjuar se si të dërguarit e Napoleonit e flisnin aq mirë, sa ai vetë, gjuhën vulgare”. Ç’kuptonte Stefanopulli me fjalët “gjuhë vulgare, me të cilën bashkëbisedoi me bashkëpatriotin e tij mysliman, Beun e Manit? Të ishte gjuha greke, do ta kishte thënë, përderisa më sipër flet për dy letrat e Napoleonit të shkruara në greqisht. A thua të ishte gjuha shqipe, për të cilën një tjetër udhëtar francez para tij, shkruante se ishte gjuha e banorëve të Manit<sup>129</sup>? Ne priremi ta besojmë një gjë të tillë. Në fund të fundit, vetë Dhimo Stefanopulli në librin e tij më se një herë e quan Manin “Shqipëria greke” (*l’Albanie grecque*)<sup>130</sup>. Dhe, në një rast ai tenton të shpjegojë origjinën e emrit të Manit (që ai e shkruan Maini) dhe thotë se në gjuhën e “Mainotëve” fjala “Maina” do të thotë brigant, hajdut. Por, shton ai, për vendasit fjala nuk ka kuptim të keq, përkundrazi ajo përdoret në kuptimin “trim”. Nuk ka dyshim, se kur rreket të bëjë etimologjinë e emrit të atdheut të tij të parë, Manit (Mainit), Stefanopulli

<sup>129</sup> D. N. Meksës, *E Mane kai oi Maniates*, Athinë: Estia, 1977, f. 34 (që citon nga: P. Kanellides, “Mane kai Maniatai”, në *Ebdomas*, f. 23, Kiprou: 4 korrik 1887).

<sup>130</sup> D. Stephanopoli, *Voyage en Grèce pendant les années 1797-1798 ...*, vol. I, f. 218; vol. II (Paris: 1800), f. 167.

ka në mend fjalën “Hajn” (hajn), që sipas tij përdorej jo aq për të treguar një grabitës, por një person që nuk i trembet vdekjes. Fjala e huazuar nga turqishtja, siç duket ishte në përdorim edhe tek shqiptarët e Manit, ashtu siç ishte tek të gjithë shqiptarët<sup>131</sup>.

Sigurisht, mbetet pyetja përse Stefanopulli, apo vetë Napoleon Bonaparti, nuk i referohen drejtpërdrejt origjinës së mundshme shqiptare. Ndoshta ngaqë maniotët e Korsikës, ishin thellësisht të helenizuar kur zbarkuan në Korsikë, pas gati tre shekuj jetese në jugun e Peloponezit. Por nuk duhet lënë jashtë konsideratës edhe fakti se jemi në kohët e Romanticizmit, kur individët e popujt rendnin pas origjinave të lavdishme. Në këtë kuptim, siç rrëfen Stefanopulli, Napoleon Bonapartit dhe atij vetë u rrinte ngushtë edhe përcaktimi si “grek”, megjithëse Greqia e lashtë dhe heronjtë e saj ishin në modë si kurrë më parë. Më shumë se “grekë” ata parapëlqenin të quheshin “spartanë”. Në fund të fundit, për ushtarakë e konkuistatorë si ata, vlente më shumë të mbaheshin si pasardhës të një populli “hajnash”, d.m.th. trimash, se sa pasardhës të një populli “filozofësh”.

### *S u m m a r y*

#### MIGRATORY WAVES OF ALBANIANS FROM MOREA TO ITALY, 15<sup>TH</sup> – 17<sup>TH</sup> CENTURIES

The friction in the relations of George Castrioti Scanderbeg with the Republic of Venice started because of the different viewpoints they had on the principal issue of the time – i.e., the attitude towards the ottoman Turks who threatened to penetrate deep into Europe. Scanderbeg believed that establishing a strong Albanian state and increasing its geopolitical importance by controlling Via Egnatia and the Strait of Otranto which could lead the ottomans to Europe, was crucial for the fight against the Turks. Actually it was his determination in fighting the Turks that brought him praise and reputation at home and abroad. The Republic of Venice, on the contrary, had had until then a history of special relations with the ottomans characterized by the tendency to

<sup>131</sup> Tahir N. Dizdari, *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë: Instituti Shqiptar i Mendimit e Qytetërimit Islam, 2005, f. 325.

---

come to terms and to avoid clashes with them. Although after 1463 it seemed as if Venice moved closer to Scanderbeg's attitude and that of the other western powers, the inclination for closer relations and peace with the Turks is obvious even after that date. Another reason that poisoned the relations between Scanderbeg and Venice came from the fact that by the time the Albanian hero returned to Albania and started his efforts to establish the Albanian state, the Republic had occupied and controlled the main Albanian towns, preventing him from making use of a necessary element for the development and international recognition of that state. Scanderbeg tried to free himself from the isolation that the Republic had forced him into by attempting to get Dania, Antivar, Drisht, Durres and Berat. However engaging in war in several fronts was not to his advantage in fighting the Venetians. The latter had their own reasons to remain distant, distrustful and hostile to Scanderbeg. His project to create a strong and unified Albanian state went against the interests of the Venetians who wanted to have to deal with small and weak Albanian provinces, in conflict and war with one another, thus easier to be controlled and influenced by the Republic. To this end, Venice worked mainly to weaken and undo the state structure that Scanderbeg managed to build in the League of Lezha in 1444, by persuading and separating from Scanderbeg powerful noble families such as the Dukagjini, the Span, the Cernojevic, the Arianit, the Topia etc.

